



2017

RAPORT VJETOR



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hr-jugor.com

1.Përmbajtja

Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR“

4

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

5

2.1	Aktivitetet dhe performancat e ndërmarrjes	5
2.1.1	Aktivitetet e ndërmarrjes gjatë vitit	5
2.1.2	Pasqyrat e performancave operative dhe financiare	7
2.1.3	Ngjarjet te cilat ndikojn ne te ardhmen e ndermarrjes	23
2.1.4	Pasqyrat e te priturave per vitin e ardhshem	23
2.2	Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendat	24
2.2.1	Kredit e rendesishme te nenshkuara apo paguara gjate vitit	24
2.2.2	Investimet gjate vitit 2017	24
2.2.3	Dividentat e paguara gjate vitit 2017	26
2.3	Te dhenat per drejtot jo- ekzekutiv	27
2.3.1	Emrat e drejtove te bordit te drejtove	27
2.3.2	Numri i takimeve te bordit te drejtove	28
2.3.3	Numri i takimeve te komiteteve te bordit	29
2.3.4	Informacionet e tjera te bordit gjate vitit	29


3 RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

40

3.1	Ngjarjet kryesore te vitit	40
3.1.1	Aktivitetet nga Shërbimi Teknik	40
3.1.2	Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	44
3.1.3	Planifikimi I investimeve emergjente	44
3.1.4	Prodhimi I ujit - m3	45
3.1.5	Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	45
3.1.6	Zyra për planifikim dhe zhvillim	46
3.1.7	Servisimi I ujëmatësave	48
3.1.8	Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	49
3.1.9	Raport per trqajtimin e ujerave te zeza	52
3.1.10	Raport I Njësive Punuese	60
3.2	Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	63
3.2.1	Aktivitetet kryesore	63
3.2.2	Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes	63
3.2.3	Raport I ankesave	64
3.2.4	Raport I faljeve te bprxheve	65
3.2.5	Raport I mediave	65

3.3	Aktivitetet e Departamentit Administrativ	69
3.3.1	Aktivitet kryesore	69
3.3.2	Personeli	74
3.3.3	Kualifikimi i punëtorëve	74
3.3.4	Numri I punëtorëve sipas nacionaliteteve	74
3.3.5	Raport i zyres ligjore	76
3.4	Raporti nga Shërbimi financiar	81
3.4.1	Aktivitetet kryesore	81
3.4.2	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor 2016	82
3.4.3	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor 2017	83
3.4.4	Progresi me Planin e Biznesit	85
3.5	Raport I aktiviteteve te prokurimit	87
3.6	Shpenzimet kapitale te projekteve gjate vitit 2017	90
3.7	Prespektiva per vitin e ardhshem	91
3.7.1	Qellimet dhe objektivat strategjike	91
3.7.2	Objektivat kryesore te KRU	91
4	RREZIQET E TË ARDHMES	92
5	PASQYRAT FINANCIARE	93
6	INVESTIMET	98
6.1	Plani I investimeve kapitale	98
6.1.1	Plani I investimeve kapitale- ujesjelles	99
6.1.2	Plani I investimeve kapitale- kanalizim	100
7	RAPORT I AUDITORIT	101
7.1	Raport i auditorit te brendshem	102
8	ORGANOGRAMI	105

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

2.1 Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes

2.1.1 Aktivitetet e ndërmarrjes gjatë vitit

FURNIZIMI

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

Kompania është angazhuar dhe ka arritur që gjatë muajve Janar-Dhjetor, 2017 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (kryesisht të lagja Dardanisë dhe në lagjen 2 Korriku ku perfshihen rruga e Janinës dhe disa rruge tjera sekondare). Për me gjëresisht është prezente tabela e reduktimeve nga Njesia Operuese ne Prizren. Sa i përket pjeses së Bazhdarhanës kryesisht banesave kolektive, jemi duke aplikuar ndryshime konform nevojës për konsum. Duhet cekur se ky ndryshim teknik është ende në provë dhe munde të kemi reduktime deri sa të finalizojmë projektin e planifikuar për ndarjen e furnizimit të lagjen Dardania me lagjen Bazhdarhana, ku pas implementimit të këtij projekti lagja Bazhdarhana, lagja 2 Korriku dhe disa rrugë sekondare do të kenë furnizim të rregullt me ujë të pijes (Ky projekt është duke u financuar nga komuna e Prizrenit dhe implementimi i ketije projekti ka filluar gjate muajit Tetor të vitit 2017). Në njësitë tjera operuese di në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes mirpo duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi aplikuar reduktime të planifikuara në varesi të defekteve të mundshme si dhe ndërprerjeve të enrgjise elektrike nga KEDS *(për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njesive Operative nga udheheqsit e Njesive)*.

UJI I PRODHUAR

Gjatë muajve Janar - Dhjetor, 2017 në nivel regional janë raportuar prodhim të ujit **17,482,425.00 m³**, krahasuar me 2016, kemi një rritje të prodhimit të ujit të pijes prej **111,212.00 m³**. Jane duke vazhduar aktivitetet për të mbajtur gjendjen stabile të furnizimit me ujë.

FATURIMI - m³

Gjatë vitit 2017 në nivel regional janë faturuar **7,366,856.00 m³** me një rritje të faturimit prej **24.430 m³ (+ 0.3%)** rahasar nga viti 2016.

FATURIMI - €

Gjatë vitit 2017 në nivel regional janë faturuar **4.254.392,72 €** me një rritje të faturimit prej **37.016,95 € (+ 0.9%)** rahasar nga viti 2016.

ARKËTIMI - €

Gjatë vitit 2017 në nivel regjional janë arkëtuar **4.008.683,50 €** me një rritje të arkëtimit prej **356.134,69 € (+ 9.3%)** rahasuar nga viti 2016.

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e defekteve sa më shpejtë.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regjional për vitin 2017 është **57,86** ose **0.15%** me rritje të UPF-së nga viti paraprak 2016.

SHPENZIMET - €

Gjatë vitit 2017 në nivel regjional shpenzimet kanë arritur në **3.558.868,84 €** me një rritje të shpenzimeve prej **177.088,84 € (+ 5.2%)** rahasuar nga viti 2016.

MBULIMI OPERATIV

Gjatë vitit 2017 në nivel regjional Kampania ka arritë të ketë mbulim operativ prej 1.13 apo **+449.814,66 €** mbi shpenzimet operative.

2.1.2 Pasqyrat e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

PRODHIMI - m3										
NJËSIA PUNUESE	JANAR-DHJETOR 2014		JANAR-DHJETOR 2015		JANAR-DHJETOR 2016		JANAR-DHJETOR 2017		JAN-DHJE 2017 (PB)	
	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	430.0	13,562,010	442.9	13,966,192	429.1	13,533,249	409.1	12,900,866	472.2	14,891,446
SUHAREKË	67.8	2,137,527	62.8	1,980,778	65.1	2,052,541	70.1	2,210,835	78.6	2,478,244
MALISHEVË	42.6	1,344,602	42.6	1,342,594	43.5	1,373,065	44.6	1,406,876	47.7	1,505,233
DRAGASH	13.9	438,560	12.5	394,480	13.0	410,758	30.6	963,848	11.2	354,420
TOTAL	554.4	17,482,699	560.8	17,684,044	551	17,369,613	554.4	17,482,425	609.8	19,229,343
NDRYSHIMI l/sec			6.38	201,345	-9.97	(314,431)	3.58	112,812	-58.97	(1,746,918)
NDRYSHIMI %				1.15%		-1.78%		0.65%		-9.88%

AKTIVITETET KRYESORE

– Kemi qenë vazhdimisht të angazhuar në mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit si dhe i kemi koordinuar dhe përcjellur punimet në projektin “Rehabilitimi i sistemeve të ujësjellësve në zonat rurale”.

Kemi instaluar edhe dy pompa shtesë, njëra te Pusi Atit dhe tjetra në lagjen Fidanishte me çka e kemi rritur prodhimin e ujit për furnizim të qytetit dhe i kemi pakësuar dukshëm reduktimet.

- **Testimi i Pusit në Agro-zonë në Samadraxhë**

Pusi Nr.2 i hapur nga Komuna e Suharekës në Agro-zonë në fshatin Samadraxhë, në mungesë të Elaboratit, është testuar nga ekipa jonë duke e vendosur pompën në thellësinë $H=100[m]$ me kapacitet 7.5 kë, mirëpo në këtë thellësi nuk ka pasur kontakt me ujin.

Në thellësi më të madhe nuk ka mundur të lëshohet pompa, prandaj praktikisht është i pa shfrytëzueshëm.

- **Vendosja e Rezervuarit montazhë me $V=15 [m^3]$ në stacionin e pompave në Dobërdelan**

Pas rënies së nivelit të ujit në thellësinë $H= 110 [m]$ dhe hapjes së pusit të ri në thellësi 150 [m], e kemi vendosur pompën në thellësi $H=135 [m]$ dhe nga kjo thellësi ka qenë e pa mundur dërgimi i ujit në Rezervuarin kryesor, prandaj në stacionin e pompave është vendosur rezervuari montazhë me $V=15 [m^3]$ si dhe janë vendosur dy pompa centrifugal me kapacitet $Q=7,5 [kë]$..

- **Hapja e kanalit me gjatësi $L = 150 [m]$ në Mushtisht**

Hapja e kanalit për vendosjen e gypit me diametër $\varnothing 40 [mm]$ në fshatin Mushtisht, për lidhjen e një objekti bujqësor (Shtallë e deleve). Gypi dhe kanali janë me shpenzime të Kompanisë.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

-Për shkak të thatësisë gjatë sezonës verore kemi pasur probleme të theksuara me rënien e nivelit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit e sidomos në disa lokalitete si në Dobërdelan, Samadraxhë, Studenqan dhe Savrovë. Në Dobërdelan e kemi zgjidhur problemin duke e hapur një pus të ri në bashkëpunim me Komunën e Suharekës, kurse në Studenqan është stabilizuar furnizimi pas të reshurave të fundit. Në Samadraxhë, Savrovë dhe Dobërdelan janë instaluar nga një pompë e re me parametra punues më të mirë se më parë, ashtu që tani furnizimi është stabilizuar.

– Kemi pasur probleme të theksuara të keqpërdorimit të ujit të pijes nga konsumatorët dhe mos gadishmëria e një pjese të tyre për të paguar faturat e ujit.

-Jemi detyruar që vazhdimisht të përcjellim lëndë te Përmbartuesi privat dhe ky veprim ka dhënë rezultate të dukshme.

MASAT E PROPOZUARA

- Propozojmë që të shikohet mundësia e shtimit të sasisë së ujit për furnizimin e qytetit, në mënyrë që të arrijmë të stabilizojmë furnizimin gjatë sezonës së ardhëshme të verës sepse me marrjen në menagjim të tri fshatrave (Gelancit, Leshanit dhe Tërnyes) gjatë vitit 2017, parashihet të ketë mungesë të ujit.
- Kontrollë e përforcuar nga ekipa jonë e kontrollës në parandalimin e keqpërdomit të ujit, duke angazhuar sipas mundësive edhe Inspektionin komunal.
- Mirëmbajtja sa më e mirë e rrjetit të ujësjetës që të kemi sa më pak humbje teknike, në mënyrë që të tejkalohet kjo situatë e rënduar e furnizimit gjatë sezonës verore.

Arsye për shtim të prodhimit të ujit në raport me vitin 2016 është rritja e numrit të konsumatorëve si dhe marrja në menagjim edhe të tri fshatrave të reja (Gelancë, Leshan dhe Tërnye), ndërsa në raport me Plan-Biznesin kemi pasur më pak prodhim për shkak se nuk kemi arritur t'i marrin në menagjim edhe disa fshatra tjera.

02 - NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA						
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2017	JANAR-DHJETOR 2017 (PB)
1	Shtëpiak	35,710	36,878	38,854	40,120	40,217
2	Ndryshimi		1,168	1,976	1,266	(97)
3	Ndryshi. %		3.01	5.09	3.25	(0.25)
4	Kome.-Indu.	4,630	5,067	5,258	5,580	5,390
5	Ndryshimi		437	191	322	190
6	Ndryshi. %		8.27	3.60	6.00	3.58
7	Institucional	625	607	521	297	627
8	Ndryshimi		(18)	(86)	(224)	(330)
9	Ndryshi. %		(3.59)	(17.03)	(50.11)	(65.35)
10	TOTAL	40,965	42,552	44,633	45,997	46,234
11	Ndryshimi		1,587	2,081	1,364	(237)
12	Ndryshi. %		3.56%	4.66%	3.05%	-0.53%

AKTIVITETET KRYESORE

- Gjatë vitit 2017 rritja e numrit të konsumatorëve ka ndodh nga muaji në muaj, rritja kryesisht ka ndodh mbrenda zonës së shërbimit.
- Është përfundu regjistrimi i konsumatorëve të fshatrave Zojz dhe Medvec , por njëkohësisht edhe në fshtra tjerë me projektin e rehabilitimit të rrjetit të fshatrave.Sapor të kryhen procedurat e nevojshme rreth marrjes nën menaxhim.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat mujore mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë
- Në përgjithësi numri i faturave të lëshuara përgjatë vitit 2017 ka pasur një trend të rritjes nga muaji në muaj, këta konsumatorë janë nga legalizimet dhe pëlqimet mbrenda zonës së shërbimit.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Pamundësia e identifikimit të 100% të rasteve të konsumatorëve të cilët veq janë kyqur në rrjet të ujësjellsit, legalizimit të tyre dhe fillimin e faturimit për shërbimet që ata marrin
- Vonesa në rehabilitime të sistemeve të zonave rurale, vendosje të ujëmatësve dhe aktivitete të tjera në mënyrë që të fillohet ofrimi i shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit edhe në këto zona.Kjo nënkupton edhe rritje të numrit të konsumatorëve.

MASAT E PROPOZUARA

- Gjatë TM1 dhe TM2 -2018 do të insistojmë që t'i marrim në menaxhim edhe lokalitete tjera, por do të varet shumë nga ecuria e kryerjes së punimeve nga Operatori i cili po i kryen këto punime, në mënyrë që mandej të fillohet me faturimin e konsumatorëve në fshtra të tjerë.
- Edhe pse kryesisht është një rritje e vogel gjatë vitit 2017, numër më të marr të rritjes së numrit të konsumatorëve priten gjatë vitit 2018 me zgjerimin e shërbimit edhe në zona rurale.

FATURIMI - m3

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

FATURIMI - m3						
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2017	JANAR-DHJETOR 2017 (PB)
1	Shtëpiak	5,942,640	6,245,390	6,174,450	6,181,862	6,889,484
2	Ndryshimi		302,750	(70,940)	7,412	(707,622)
3	Ndry. %		5.1	(1.1)	0.1	(11.3)
4	Kome.-Indu.	487,779	519,597	541,990	579,416	609,085
5	Ndryshimi		31,818	22,393	37,426	(29,669)
6	Ndry. %		6.5	4.3	6.9	(5.7)
7	Institucional	749,562	690,234	625,986	605,578	667,688
8	Ndryshimi		(59,328)	(64,248)	(20,408)	(41,702)
9	Ndry. %		(7.9)	(9.3)	(3.3)	(6.0)
10	TOTAL	7,179,981	7,455,221	7,342,426	7,366,856	8,166,257
11	Ndryshimi		275,240	(112,795)	24,430	(823,831)
12	Ndry. %		3.8	(1.5)	0.3	(11.1)

AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi pasur rritje graduale të faturimit në [m³] përgjatë vitit 2017 , për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve. Nga muaji në muaj kemi përafërsisht një trend të rritjes deri në tremujorin e fundit ku fillon edhe rënia e faturimit për shkak të rënies së konsumit sezonal.
- Faturimi është bërë nga leximet e ujëmatësve në teren, ku te konsumatorët pa ujëmatës faturimi është bërë edhe në bazë të listës për konsumatorët pa ujëmatës.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Humbjet komerciale, lidhjet jashtë orës po ndikojn në konsumin e paautorizuar e më pastaj edhe në faturim të konsumit të faturuar.
- Numri i madh i konsumatorëve që faturohen vetëm me taksë mujore. Këta konsumatorë shfrytëzojnë pusët e tyre për furnizim me ujë, e të cilët në të shumtën e rasteve janë raste potenciale për keqpërdorimin e ujit të pijes.

MASAT E PROPOZUARA

- Zvoglimi i humbjeve komerciale
- Leximi dhe faturimi i saktë i konsumit të ujit .
- Marrja në menagjim e fshatrave të reja dhe fillimi i faturimit të shërbimeve të ujësjellsit edhe në zona rurale

FATURIMI - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

FATURIMI - €						
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2017	JANAR-DHJETOR 2017 (PB)
1	Faturimi-€	3,956,133.19	4,160,752.77	4,139,427.84	4,166,205.12	4,478,618.37
2	Total- Shte.	2,793,153	2,998,067.84	2,999,760.72	3,015,744.09	3,259,236.17
3	Ndryshimi		204,914.94	1,692.88	15,983.37	(243,492.08)
4	Ndry. %		7.3%	0.1%	0.5%	-8.1%
5	Total- kome.	648,687	693,328.00	702,222.65	694,471.40	753,407.36
6	Ndryshimi		44,640.64	8,894.65	(7,751.25)	(58,935.96)
7	Ndry. %		6.9%	1.3%	-1.1%	-8.5%
8	Total-Inst.	514,293	469,356.93	437,444.47	455,989.63	465,974.84
9	Ndryshimi		(44,936.00)	(31,912.46)	18,545.16	(9,985.21)
10	Ndry. %		-8.7%	-6.8%	4.2%	-2.1%
11	Te tjera	109,391	99,388.39	77,947.93	88,187.60	61,192.97
12	Total	4,065,523.73	4,260,141.16	4,217,375.77	4,254,392.72	4,539,811.34
13	Ndryshimi		194,617.43	(42,765.39)	37,016.95	(285,418.62)
14	Ndry. %		4.8%	-1.0%	0.9%	-6.7%

AKTIVITETET KRYESORE

- Krahas rritjes së konsumit edhe faturimi në euro ka trend të rritjes përveq faturimit gjatë muajve të tremujorin të katërt.
- Faturat janë shtyp dhe shpërnda në baza mujore tek të gjithë konsumatorët

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Vështirësi në leximin e ujëmatësve për shkak të një numri të madh të pusetave të pa përshtatshme për lexim.
- Përkushtimi jo i duhur edhe i Inkasantëve në leximin e rregullt të ujëmatësve.
- Numri i madh i konsumatorëve në raport me Inkasantët që i kemi në teren.
- Numri i madh i konsumatorëve që faturohen vetëm me taksë mujore.

MASAT E PROPOZUARA

- Inkurajimi i Inkasantëve në leximin sa më korrekt të ujëmatësve
- Ofrimi i përkrahjes edhe nga punonjësit tjerë të njësisë në raste të veqanta kur nuk mund të bëhet leximi vetëm nga Inkasanti.
- Shtimi i numrit të Inkasantëve krahas rritjes së numrit të konsumatorëve dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.

SHPENZIMET

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

SHPENZIMET						
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2017	JANAR-DHJETOR 2017 (PB)
1	Total Shpenzimet Operative	3,068,484.22	3,168,617.00	3,381,781.00	3,558,868.84	3,423,132.97
2	Pagat	1,728,729.68	1,769,145.00	1,860,957.71	1,995,391.18	2,008,547.73
3	Rryma elektrike	798,223.88	872,795.00	854,176.83	893,939.67	909,256.97
4	Shpen. e derivateve	97,125.75	82,704.00	65,895.33	71,556.89	64,928.77
5	Mirem. dhe riparimet	260,262.73	181,218.00	242,429.91	198,508.42	193,518.94
6	Mirem. e automjeteve				43,921.49	27,245.96
7	Shpen.e taksave	-			96,998.00	33,643.58
8	Kemikaliet	7,029.21	12,142.00	12,607.13	9,837.10	13,969.47
9	Shpenzimet e tjera	177,112.97	250,613.00	345,714.09	248,716.09	172,021.55
2	Ndryshimi		100,133	213,164	177,088	135,736
3	Ndryshimi ne %	-	3.3%	6.7%	5.2%	4.3%

Arsyeshmëria e shpenzimeve 2016 - 2017

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për vitin 2017, në krahasim me shpenzimet e vitit 2016, janë më të larta, duke ditur se ndërmarrja ka rritur kapacitetin e saj operativ, gjë që ka ndikuar edhe në rritjen e performancës.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo uljes së tyre;

- Pozicioni i shpenzimeve të pagave, në këtë pozicion kemi rritje të shpenzimeve në krahasim me vitin e kaluar, për shkak se në këtë vit kemi një numer mesatar më të lartë të të punësuarve. Gjithashtu edhe shtesat kanë qenë më të larta, sidomos në sezonin veror edhe performanca e inkasimit ka qenë më e lartë, dhe kjo ka ndikuar edhe në rritje të shtesave për puntorë.

- Edhe të shpenzimet e energjisë elektrike kemi një rritje të vogël të shpenzimeve në krahasim me vitin e kaluar, kjo ka ardhur nga nevoja më e lartë e konsumit për ujë si dhe shtimit të pikave pompuese.

- Te pozicioni i derivateve kemi një rritje të vogël në këtë vit, pozicion që nuk ka ndikuar pothuaj se fare në shpenzime totale.

- Ndërsa në pozicionin e mirëmbajtjes dhe riparimeve kemi një rënje të shpenzimeve në krahasim me vitin e kaluar. Kjo ka ardhur nga nevoja më e vogël në mirëmbajtje në rrjetin ekzistues.

- Por te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve kemi rritje të këtyre shpenzimeve, pasi që në vitin 2017 kemi pas blerje të veturave, gjë që ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre.

- Edhe të shpenzimet e taksave kemi rritje të kësaj kategorie, për shkak së në vitin 2017 kemi pas shumë më shumë rastë të dërguara tek përmbaruesi.

- Te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e dhuratave për punëtor etj, kemi një rritje të këtyre shpenzimeve, pasi që në fund vit kemi dhënë dhurata për punëtorët e kompanisë. Gjithashtu edhe dhurata për bashkëpunorët si kalendarë, notesa, etj.

Pra si përfundim, shpenzimet për këtë vit kanë qenë më të larta në krahasim me vitin 2016, për arsyet e cekura me lartë.

JANAR - DHJETOR 2017

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A - PRIZREN

Nr.	MUAJI	PRIZREN	SUHAREKË	DRAGASH	MALISHEVË	HIDROREGJIONI	BORDI	TOTAL
1	JANAR	235	37	15	35	322	6	328
2	SHKURT	235	36	15	35	321	6	327
3	MARS	239	36	16	36	327	6	333
4	PRILL	239	36	15	35	325	6	331
5	MAJ	240	36	16	35	327	6	333
6	QERSHOR	238	36	16	36	326	6	332
7	KORRIK	240	36	15	35	326	6	332
8	GUSHT	239	36	16	35	326	6	332
9	SHTATOR	240	37	15	35	327	6	333
10	TETOR	240	37	15	35	327	6	333
11	NËNTOR	239	38	15	34	326	6	332
12	DHJETOR	238	38	17	34	327	6	333
	PB- 2017	233	39	20	37	329		
	NDY. PB.	5	-1	-3	-3	-2		

ARKËTIMI -€
REALIZIMI I CAQEVE - JANAR-DHJETOR - 2017
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN

No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2017	JANAR-DHJETOR 2017 (PB)
1	Total- Shtëpiak	1,996,699.73	2,136,660.93	2,643,393.02	2,974,352.34	2,824,654.74
2	Ndryshimi		139,961.20	506,732.09	330,959.32	149,697.60
3	Ndry. %		7.0%	23.7%	12.5%	7.0%
4	Total-Komercial-Industrial	364,088.30	438,552.45	450,873.50	477,742.11	483,133.44
5	Ndryshimi		74,464.15	12,321.05	26,868.61	(5,391.33)
6	Ndry. %		20.5%	2.8%	6.0%	-1.2%
7	Total Institucional	626,650.83	444,844.97	515,476.03	494,434.98	436,696.17
8	Ndryshimi		(181,805.86)	70,631.06	(21,041.05)	57,738.81
9	Ndry. %		-29.0%	15.9%	-4.1%	13.0%
10	Total - ujë	2,987,438.86	3,020,058.35	3,609,742.55	3,946,529.42	3,744,484.35
11	Ndryshimi		32,619.49	589,684.20	336,786.87	202,045.07
12	Ndry. %		1.1%	19.5%	9.3%	6.7%
13	Te tjera	88,205.07	51,037.83	42,806.26	62,154.07	51,262.68
14	Ndryshimi		(37,167.24)	(8,231.57)	19,347.81	10,891.39
15	Ndry. %		-42.1%	-16.1%	45.2%	21.3%
16	TOTAL	3,075,643.93	3,071,096.18	3,652,548.81	4,008,683.50	3,795,747.03
17	Ndryshimi		(4,547.75)	581,452.63	356,134.69	212,936.47
18	Ndry. %		-0.1%	18.9%	9.8%	6.9%

AKTIVITETET KRYESORE

- Viti 2017 ka qenë ndër vitet më të sukseshme në inkasimin e mjeteve. Përveq aktiviteteve të shtuara nga shërbimi me konsumatorë në rritjen e inkasimit, ndër faktorët kryesor në rritje të inkasimit ishte edhe periudha e implementimit të Ligjit të Faljes së Borxheve , i cili ligj i dha një impuls pozitiv arkëtimit të mjeteve dhe kontraktimin e këtyre borxheve.
- Personat përgjegjës nga shërbimi me konsumatorë kanë qenë të mobilizuar që të ju mundësoj konsumatorëve dhënien e informacioneve dhe kontraktimin e borxheve gjatë gjithë periudhës implementuese të Ligjit mbi Faljen e Borxheve.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Si zakonisht, problemet kryesore në këtë aspekt janë mos gadishmëria e qytetarëve për të kryerë obligimet ndaj Kompanisë.
- Shpenzimet e taksave në angazhimin e Përmbauesit për të arkëtuar mjetet.
- Numri i madh i konsumatorëve që faturohen vetëm me taksë mujore.

MASAT E PROPOZUARA

- Shërbimi sa më i mirë në furnizimin e rregulltë me ujë.
- Angazhime shtesë të ekipeve të kontrollës dhe shkyqjes.
- Përkushtimi i vazhdueshëm i inkasantëve dhe kontrollës në leximin dhe faturimin sa më korrekt të konsumatorëve si dhe insistimin në arkëtimin e mjeteve.

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

Treguesit e Performancës		JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2017	JANAR-DHJETOR 2017(PB)
Uje i faturuar-si perqindje	%	38.07	42.17	42.27	42.14	42.47
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	61.93	57.83	57.73	57.86	57.53
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	61.89	71.97	87.20	94.62	83.61
Norma e arketimit - Amviserite	%	58.48	69.79	88.12	98.47	86.67
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	47.60	64.14	64.21	68.79	64.13
Norma e arketimit -Institucional	%	99.29	98.01	117.84	108.43	93.72
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.00	0.95	1.12	1.13	1.11
Staf per 1000 konsumatore	numer	6.54	7.12	7.17	7.04	7.12

AKTIVITETET KRYESORE

- Norma e përgjithshme e inkasimit gjatë vitit 2017 është e kënaqshme, te bizneset dhe institucionet vërehet një ndryshim si përqindje (e cila nuk është reale).Ky dallim ekziston pasi që një numër i pagesave te kategorisë së bizneseve postohen (ruhen) nga softveri tek institucionet. Për këtë problem është njoftuar edhe kontraktuesi i mirëmbajtjes së softverit dhe kemi marrë premtime që ky problem do të rregullohet.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Rritje e numrit të konsumatorëve për një inkasant në disa raste po e pamundëson që të vizitohen të gjithë konsumatorët e terrenit mbrenda muajit.
- Pamundësia e pagesave të faturave mujore nga të gjithë konsumatorët
- Numri aktual prej gjashtë inkasantëve është i detyruar që të mbuloj secili mbi një mijë konsumatorë, prandaj kemi vështirësi në lexim, faturim dhe arkëtim të mjeteve.

MASAT E PROPOZUARA

- Angazhim shtesë të ekipeve të kontrollës dhe inkasantëve në teren
- Rritje e numrit të konsumatorëve në inkasim të mjeteve përmes përmbarimit
- Vazhdimi i aksionit të shkyqjeve të konsumatorëve borxhlinj

2.1.3 Ngjarjet të cilët ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Gjatë tri viteve të ardhshme Kompania mund t ballafaqohet me rritje të çmimit të energjise elektrike si dhe me rënie të vazhdueshme të burimeve të ujit të pijes që si pasojë mund të sjellë edhe deri tek rritja e reduktimeve të furnizimit.

Rritja e konsumatoreve me raste sociale, moszhvillimi ekonomik mund të ndikojë në rënie të arketimit.

Kompania ka marrë masa konkrete në gjetjen e burimeve alternativ që do të rritë sigurinë e kompanisë në sigurimin e furnizimit me ujë të pijes edhe në raste emergjente.

Këto masa janë diskutuar edhe me institucionet tjera relevante si dhe me donatore të ndryshëm, nga të cilët edhe presim përkrahje financiare.

2.1.4 Pasqyra e të priturve për vitin e ardhshëm

Si qellime kryesore të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. janë:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit të ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e lëshuara ngarregullorret në fuqi.
- Rritja e shkallës së inkasimit si dhe zvogëlimi i ujit të pafaturuar
- Rritja e shkallës së efikasitetit të punëtorëve.

Performancat e pritura për vitin 2017

Treguesit e Performancës		2017	2018	2019
Uje i faturuar-si perqindje	%	42.47	42.83	42.97
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	57.53	57.17	57.03
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	83.61	84.40	85.73
Norma e arketimit - Amviserite	%	86.67	87.49	91.20
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	64.13	64.74	63.52
Norma e arketimit -Institucional	%	93.72	94.61	85.67
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.11	1.13	1.16
Staf per 1000 konsumatore	numer	7.12	6.60	6.32

2.2 Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendet

Vlera e kapitalit eshte rritur per + 926.000 €. Divident nuk eshte raportuar

2.2.1 Kredit e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2017, me qëllim te blerjes se nje automjeti eshte nënshkuar kredi ne shume prej 21.192,00 € (jane paguar 4.949.00 €) .

2.2.2 Investimet e rëndësishme gjatë vitit 2016

Investimet nga Qeveria gjermane - KfW

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore	KfW	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore (BMZ 2010 65 663)	PASSAVANT AQUALIA	Traltimi I Ujerave te Zeza, Mbrojtja e burimeve nentokesore te ujit dhe permiresimi I shendetit te popullates (VIJIM)	12,000,000.00 Ne vijim
2	Eficienca ne energjine elektrike	KfW		/	Ndrrimi dhe Ridemninsionimi I gypave kryesor transportues nga 40 burmjet deri te rrjeti shperndares ne Prizren, si rezultat I rritjes se kapacitetve te ujit te lokacioni 40 burimet, me crast do te kemi furnizim 24 oresh afatgjate per gjithe qytetin e Prizrenit me energjise elektrike. (VIJIM)	2,500,000.00 Ne vijim
	Pajisje me Automjet	Pm2Berlin		Pm2Berlin	Permiresimi i sherbimeve	8,865.96 €
3	TOTAL					8,865.96 €

Investimet nga Qeveria Zvicerane- DORSCH-CDI

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Programi mbi rehabilitimin dhe sistemin e ri te UJESJELLSAVE TE fshatrave te cilat nuk jane nen menaxhim te HRJ	QEVERIA ZVICERABE - (DORSCH-CDI)		Disa kontraktues...	Faza I Rehabilitimi I ssiteve egzistuese qe nuk jane nen menaxhim te HRJ Faza II ndertimi isistemeve te reja te ujesjellesit ne Komunat ku menaxhon HRJ (VIJIM)	509,631.07 € (Ende ne vijim)
3	TOTAL					509,631.07 €

Investimet nga MZHE - MMPH,MF

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore	MZHE	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore (BMZ 2010 65 663)	PASSAVANT + AQUALIA	Tralimi I Ujerave te Zeza, Mbrojtja e burimeve nentokesore te ujit dhe permiresimi I shendetit te popullates (VIJIM)	1,411,623.77 € Ne vijim
4	TOTAL					1,411,623.77 €

Investimet nga Kuvendet Komunale

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore	Komuna e Prizrenit	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore (BMZ 2010 65 663)	PASSAVANT + AQUALIA	Tralimi I Ujerave te Zeza, Mbrojtja e burimeve nentokesore te ujit dhe permiresimi I shendetit te popullates (VIJIM)	6,000,000.00 VIJIM
2	Zgjerimi I rrejtit ne doberdelan	KK-Suharekë	HJ-16*014-521	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	8,474.58 €
8	TOTAL					8,474.58 €

Investimet nga KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Pajisja me tri automjete	KRU	Nr. 67/17 - 103/17	Auto mita . Shpk- Artius grup	Permiresimi I sherbimeve	42,021.75 €
2	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore	KRU			Permiresimi I sherbimeve	36,627.33 €

3	Rregullimi I pusetes tek Bunari I	KRU	Fat. Nr,4	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	1,581.19 €
4	Rregullimi I kaptazhes te 40 Burimet	KRU	Fat. Nr.7	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	6,105.93 €
5	Rregullimi I burimit tek burimi - CVILENI	KRU	Fat. 6	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	8,644.70 €
6	Rrregullimi I kaptazhes ne fsh. Lladrovç- MA	KRU	Fat. Nr. 2	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	4,500.00 €
7	Rregullimi I rezervarit dhe kaptazhes I ujit te pijes ne fshatin Gjonaj	KRU	43+46+57/17	ALBING	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	38,461.41 €
8	Zgjerimi irrjetit ne Mushtisht	KRU	Nr. 39	ENDRITI	Permiresimi I furnizimit	13,309.67 €
9	Zgjerimi i ujesjellesit-Shirok	KRU	Fat. Nr. 107/6	XERXE/ ENDRIT	Zgjerimi I rrjetit	2,951.00 €
10	Zgjerimi i ujesjellesit-Doberdelan	KRU	Fat. Nr. 3+9	BURIMI/ENTRII	Zgjerimi I rrjetit	11,231.35 €
11	Rregullimi I kaptazhes - Dobrush	KRU	Fat. Nre, 10+11	BURIMI	Permiresimi I furnizimit	13,686.44 €
12	Furnizim me pajisje dhe mjete pune	KRU	Nr. 19062017/1	Npt "Moni"	Permiresimi I kushteve te punes	14,576.76 €
13	Furnizim me pajisje dhe mjete pune	KRU	PJ-16-004-121	HiTERM	Permiresimi I kushteve te punes	43,013.84 €
14	Furnizim paisje per zyre dhe IT	KRU	Nr. I Fat. 27122016-09		Permiresimi I kushteve te punes	9,191.61 €
TOTAL						245,902.98 €

Investimet vetanake nga KRU 245.902,98€

Investimet nga donatoret..... 1.936.834,26 €

TOTAL 2.182.737,24 €

2.2.3 Dividentet e paguara gjatë vitit 2017

Kompania nuk ka patur dividende të paguara gjatë vitit 2017

2.3 Të dhënat për drejtor jo-ekzekutiv

2.3.1 Emrat e drejtorëve të bordit të drjetorëve

Rexhep Manxhuka

Kryesues i Bordit

Mob.: 045 / 223 563

044 / 163 120

e-mail: rexhep-manxhuka@hotmail.com

Ridvan Hoxha

Anëtar i Bordit

Mob.: 049/ 560 007

e-mail: rhoxha7@hotmail.com

Alban Zulfaj

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 290 047

049 / 290 047

e-mail: alban_zulfaj@hotmail.com

Ylber Kuqi

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 303 372

e-mail: ylber.kuqi@rks-gov.net / belkuqi@hotmail.com

Ramadan Abazi

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 256 905

e-mail: r-abazi@hotmail.com

Reshit Makica

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 184 528

e-mail: reshitmakica@hotmail.com

Besim Baraliu

Anëtar i Bordit

(Kryeshef Ekzekutiv)

Tel.&Fax.: 029 / 244 150 Mob.: 045 / 322 131

e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

2.3.2 Numri i takimeve të bordit gjatë vitit

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	30.01.2017	Prizren	
2	01.03.2017	Prizren	
3	31.03.2017	Prizren	
4	26.04.2017	Prizren	
5	29.05.2017	Prizren	
6	02.06.2017		
7	13.06.2017	Prizren	Mbledhja e Përgjithshme vjetore me Aksionarin
8	30.06.2017	Prizren	
9	27.07.2017	Prizren	
10	29.08.2017	Prizren	
11	29.09.2017	Prizren	
12	31.10.2017	Prizren	
13	27.11.2017	Prizren	
14	29.12.2017	Prizren	

Komisioni i Auditimit ka mbajtur nëntë (9) takime gjatë vitit 2017, sipas procesverbaleve takimet janë mbajtur ne këto data: 25.01.2017; 27.02.2017; 24.03.2017; 25.04.2017; 26.05.2017; 26.07.2017; 25.08.2017; 25.09.2017; dhe 22.12.2017.

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	25.01.2017	Prizren	
2	27.02.2017	Prizren	
3	24.03.2017	Prizren	
4	25.04.2017	Prizren	
5	26.05.2017	Prizren	
6	26.07.2017	Prizren	
7	25.08.2017	Prizren	
8	25.09.2017	Prizren	
9	22.12.2017	Prizren	

2.3.3 Numri i takimeve të komiteteve të bordit gjatë vitit

Komiteti i financave ka mbajtur dy (2) takime gjatë vitit 2017 sipas procesverbaleve takimet janë mbajtur ne këto data: 22.05.2017 dhe 23.11.2017.

MBLEDHJET E KOMITETIT TË FINANCAVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	22.05.2017	Prizren	
2	23.11.2017	Prizren	

2.3.4 Informacione të tjera të bordit gjatë vitit

KUR Hidroregjioni Jugor udhëhiqet nga Bordi i drejtorëve të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.11/56 të datës 30.10.2015. Bordi përbëhet nga 6 drejtorë, ndërsa Komisioni i auditimit përbëhet nga 3 anëtarë.

Raporti vjetor i Bordit të Drejtorëve, të KRU”Hidroregjioni Jugor”sh.a në Prizren, në formë përmbledhëse përfshinë aktivitetet dhe punët të cilat i ka realizuar gjatë vitit 2017.

Bazë apo burim i të dhënave gjatë përgatitjes së këtij raporti vjetor, janë procesverbalet zyrtare të mbajtura në takimet e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë vitit 2017 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 14 takime të rregullta mujore, sipas procesverbaleve takimet e Bordit janë mbajtur me këto data: 30.01.2017; 01.03.2017; 31.03.2017; 26.04.2017; 29.05.2017; 02.06.2017; 13.06.2017; 30.06.2017; 27.07.2017; 29.08.2017; 29.09.2017; 31.10.2017; 27.11.2017; 29.12.2017.

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 30.01.2017 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U ”Hidroregjioni Jugor”, miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM4 për vitin 2016 .

Në këtë takim Bordi i Drejtorëve rekomandon menaxhmentin e Kompanisë që në të ardhmen të rritet norma e arkëtimit dhe shpenzimet të zvogëlohen aty ku ka mundësi.

Në këtë takim është shqyrtuar Kërkesa e Udhëheqësve të njërive punuese në Suharekë, Malishevë dhe Dragash për anulimin e Vendimit mbi ndarjen e shpenzimeve rajonale në mënyrë proporcionale nëpër njësi punuese.

Bordi pas diskutimit dhe shqyrtimit të bërë të kërkesës në fjalë Bordi i Drejtorëve mori :VENDIM që të Ç’fuqizohet Vendimi i Bordit të Drejtorëve i datës 29.07.2016.

Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi kërkesën e Udhëheqësve të njërive punuese të Suharekës, Malishevës dhe Dragashit për anulimin e Vendimit mbi ndarjen e shpenzimeve rajonale në mënyrë proporcionale në bazë të numrit të konsumatorëve dhe shpenzimet rajonale të barten vetëm nga njësia e Prizrenit. Pagesa e shpenzimeve rajonale nga njësia e Prizrenit të evidentohen në një pozicion si shpenzime të veçanta.

Pastaj është shqyrtuar Ankesa Udhëheqësve të njërive punuese në Suharekë, Malishevë dhe Dragash, mbi Vendimin e Kryeshefit nr. 1760 për ndëshkimin e punëtorëve me -10% të pagës për

njësit në fjalë, Bordi i Drejtorëve refuzoj si të pa bazë Ankesën e parashtruar nga udhëheqësit e njërive në fjalë mbi Vendimin e Kryeshefit nr.1760 për ndëshkimin e punëtorëve me -10% të pagës dhe vendosi që Vendimi i marrë nga Kryeshefi Ekzekutiv të zbatohet sipas rekomandimit të Bordit.

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 01.03.2017, në këtë takim nga shërbimi teknik është bërë prezantimi i aktiviteteve të projektit të ujërave të zeza dhe asistencës teknike. Bordi i Drejtorëve vlerësoj lartë raportet e punës të prezantuara nga Menaxheri teknik, Udhëheqësi për planifikim, zhvillim dhe Menaxheri i projekteve dhe sugjeroj që kjo punë të intensifikohet edhe në njësitë e tjera punuese, po ashtu të ndikojnë në afarizëm pozitivë të Kompanisë.

Në këtë takim është shqyrtuar Raporti nga Komisioni për nivelizimin e pagave, Bordi i Drejtorëve rekomandoj Komisionin për nivelizim të pagave që pas një muaji të paraqet raport të përfunduar të nivelizimit të pagave të punëtorëve duke përfshirë edhe koston e përgjithshme financiare të Kompanisë.

Po në këtë takim Në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore, Bordi i Drejtorëve me VENDIM miratoi Raportin vjetor Operativ dhe Financiar për vitin 2016.

Në këtë takim është diskutuar edhe blerja e veturës zyrtare të Kompanisë për Kryeshefin Ekzekutiv. Bordi i Drejtorëve pasi shqyrtoj dhe diskutoj procedurat e blerjes së veturës dhe pasi konstatoj se ndërprerja e procedurës dëmtojnë financiarisht Kompaninë mbasi është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik dhe vendosi që të vazhdohet me përfundimin e procedurave të blerjes së veturës zyrtare të Kompanisë.

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me date 31.03.2016, Pas diskutimit lidhur me marrjen në menaxhim nga KRU"HRJ" ujësjellësit që vet menaxhohen Bordi i Drejtorëve rekomandoj që të iniciohen dhe realizohen takime pune me përfaqësuesit e KNMU, NJPMNP-MZHE, Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin e Kompanisë për inkorporim në Kompani të gjithë ujësjellësit e zonave rurale që vet menaxhohen.

Bordi i Drejtorëve pasi konstatoj se nuk tejkalohet planifikimi i pagave i planifikuar në planin tarifor për vitin 2017, miratoi propozimin e Komisionit të Auditimit për koeficientet e propozuar për pozitat e punës së punëtorëve të operativës për të gjitha njësit punuese.

Në këtë takim Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Raportet mbi Përmbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me: VENDIM miratoi raportin mbi Hulumtimin e Knaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2016 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren.

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 26.04.2017, Në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K. R. U" Hidroregjioni Jugor "Sh. A, me: VENDIM njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM1 për vitin 2017.

Në këtë takim duke u mbështetur në nenin 20 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike dhe Neni 12 të ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, për Politikën e Kompensimit për stimulimin e efektshmerisë në bazë të performancës për Bordin e Drejtorëve dhe Zyrtarët e KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh.A, Bordi i Drejtorëve me: VENDIM - Apropoj njëzëri Deklaratën për politiken e Kompensimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU"Hydroregjionit Jugor "sh.a për vitin 2016 pasi e njëjta është aprovuar në Komision të Auditimit në takimin e dt. 25.04.2017.

Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU"Hydroregjioni Jugor"aprovj njëzëri pa vërejtje Rregulloret si në vijim:

Rregullore 01/2016 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve

Rregullorja Nr 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit

Rregullore Nr. 03 /2017 për Procedurat e Ndërprerjes së Shërbimeve të Ujit

Rregullore Nr. 04/2017 për Procedurat e Faturimit për Shërbimet e Ujit

Rregullore Nr. 05/2017 për Matjen e Konsumit të Ujit

Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 29.05.2017, për shkak se në takim ka munguar materiali i kërkuar për diskutim Bordi i Drejtorëve njëzëri vendosi që takimi të anulohet dhe të shtyhet deri te përgatitja e materialit të kërkuar për takim të Bordit nga shërbimi i financave si dhe që në takim të radhës të jet prezent edhe Auditori i Jashtëm ngase është duke munguar edhe Letër menaxhmenti i Auditorit të Jashtëm.

Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 02.06.2017, Bordi i Drejtorëve kërkoj nga menaxhmenti i Kompanisë që rekomandimet e dala nga Komisioni i Auditimit dhe Komiteti i financave të zbatohen nga shërbimet përkatëse.

Në këtë takim Bordi i drejtorëve e përkrahu dhe kërkoj të zbatohen nga shërbimet përkatëse kërkesat e Kryesuesit të Bordit lidhur me rritjen e aktiviteteve të inkasantëve, ekipet e kontrollës, ekipet e laboratorit të Kompanisë për marrje të mostrave të ujit në të gjitha burimet e ujit që menaxhohen nga Kompania duke përfshirë dhe fshatrat si dhe të zvogëlohen humbjet e ujit në rrjet të ujësjellësit.

Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Snë përputhje me nenin 33 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Auditimin e Jashtëm të NP, me: VENDIM - miratoi Pasqyrat Financiare 2016 dhe Letër Menaxhmentin e Auditorit të Jashtëm, me rekomandimin vijues.

Bordi i Drejtorëve rekomandoj Menaxhmentin e Kompanisë që të angazhoj ekspert nga jashtë dhe brenda Kompanisë që të bëjë rivlerësimin e jetë gjatësisë së asetëve të KRU "Hidroregjioni Jugor" sh. a Prizren, dhe pas kësaj të bëhet edhe rishikim i pasqyrave financiare të Kompanisë për vitin 2016.

Bordi i Drejtorëve bëri vlerësimin e kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë për vitin 2016: Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar, Sekretaren e Kompanisë ndërsa nga Komisioni i Auditimit u vlerësua Auditori i Brendshëm i Kompanisë.

Bordi i Drejtoreve në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin me datë 13.06.2017 Bordi i Drejtoreve në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin miratoi:

- Pasqyrat Financiare të Audituar nga Auditori i Jashtëm për 2016.
- Raportin vjetor për vitin 2016.
- Performancën e Menaxhmentit të Kompanisë për vitin 2016.

Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 30.06.2017

Bordi i Drejtorëve kërkoj nga Auditori i Brendshëm që të bëjë raport të auditimit për pasqyrat e shpenzimeve për janar-qershor 2017 për njësinë punuese të Suharekës dhe të Malishevës si dhe të bëhet auditim të pozicionit të pagave në nivel rajonal të Kompanisë për janar-qershor 2017 duke krahasuar me planifikimin e pagave në Planë Biznes.

Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e datës 27.07.2017, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U "Hidroregjioni Jugor" me: VENDIM - njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM2 për vitin 2017.

Rekomandimi i Bordit në takim ishte pasi që kërkesa e Bordit për revidim të Plan-biznesit nuk është realizuar nga shërbimet përgjegjëse si shërbimi i financave, për konsumator dhe shërbimi teknik, atëherë caqet e planifikuara në Plan-biznes 2017 nëse nuk arrihen deri në fund të këtij viti do të merren masa ndëshkuese për udhëheqësit e këtyre shërbimeve.

Bordi i Drejtorëve me Autorizim konfirmoj se Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni jugor" Sh.A, Prizren ka mandat dhe autorizim të plotë në emër të Ofruesit të

përmendur të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit për të aplikuar për Tarifa të Shërbimit dhe për të ofruar dokumentet e nevojshme sipas Rregullës për Aplikimin Tarifor për periudhën 2018-2020 në Autoritetin Rregullatorë për ujë.

Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU" Hidroregjioni Jugor" pas shqyrtimit të bërë aprovoj njëzëri pa vërejtje "Udhëzimin për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë në KRU" Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren ".

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 29.08.2016,

Pas diskutimit të bërë Bordi i Drejtorëve aprovoi Raportin e përfundimit operative dhe financiare të Kompanisë për muajin korrik 2017 duke kërkuar sqarime shtesë nga udhëheqësit e njësive punuese.

Nga Udhëheqësi i njësive punuese të Malishevës u kërkuar sqarim për rënien e numrit të konsumatoreve për 77 konsumator, nga Udhëheqësi i njësive punuese të Suharekës sqarim për rritjen e shpenzimeve të tjera dhe shkallën e ulët të përfundimit, ndërsa nga Udhëheqësi i njësive të Dragashit për humbjen e ujit.

Nga udhëheqësit e këtyre njësive Bordi i Drejtorëve kërkoi gjithashtu raport lidhur me aktivitetet e medieve për secilën njësi punuese dhe këto sqarime të prezantohen në takimin e radhës të Bordit të Drejtorëve.

Rekomandim - Përveç ndryshimit të propozuar nga Komisioni i Auditimit, Bordi i Drejtorëve rekomandon menaxhmentin e kompanisë që të bëhet plotësim-ndryshimi i vendimit të normës së punës për ekipet kontrolluese dhe në vendim të përfshihen:

40 Shkyqje nga njësia punuese Prizren

10 Shkyqje nga njësia punuese Suharekë

10 Shkyqje nga njësia punuese Malishevë

05 Shkyqje nga njësia punuese Dragash

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 29.09.2017, Bordi i Drejtorëve rekomandoj menaxhmentin e Kompanisë që të reagoj me komunikatë të shkruar në media që kandidatët për kryetarë të partive politike në Prizren të mos i dezinformojnë qytetarët lidhur me ujë të pijes .

Bordi i Drejtorëve njëzëri vendosi dhe rekomandoj menaxhmentin e Kompanisë të marr Vendim që inkasat të stimulohen vetëm nga të hyrat apo mjetet monetare që realizojnë në teren jo edhe nga mjetet apo të hyrat që vinë përmes përmblyesve privat, portoarkat dhe kontratat për falje të borxheve siç është vepruar deri me tani.

Nga 7 anëtarët e Bordit sa ishin të pranishëm në takim, 4 votuan për rritje të normativit të inkasatëve për 5% dhe 3 votuan për rritje për 10%. Pasi që votimi ishte me shumë për rritje të normativit për 5% u vendos që Norma e limitit të inkasatëve të rritet për 5% për bazën paraprake për tetor-dhjetor 2017 me rishikim të rezultatit pozitiv apo negativ në janar të 2018.

Pas diskutimit të bërë Bordi i Drejtorëve aprovoi Raportin e përfundimit operative dhe financiare të Kompanisë për muajin gusht 2017 , për takimin e radhës së Bordit u kërkuar sqarime shtesë nga udhëheqësit e njësive punuese për rritje të shpenzimeve në disa prej caqeve të përfundimit në gusht, arsyetim për të humbja e ujit dhe rënia e numrit të konsumatorëve.

Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU" Hidroregjioni Jugor" pas shqyrtimit të bërë aprovoj njëzëri pa vërejtje "Rregulloren e Kompanisë për iniciimin e procedurës përmblyesive të organi përmblyesive".

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 31.10.2016, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh.A , me : VENDIM - njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM3 për vitin 2017 .

Në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Plan-Biznes, me: VENDIM miratoi Planë - Biznesin për vitin 2018-2020.

Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 27.11.2017 ,

Bordi aprovoj propozimin e Kryeshefit Ekzekutiv për vendosjen e gypit shtesë për furnizim Ø315 krahas projektit të vendosjes së gypit Ø700 për efqenc të energjisë elektrike nga 40 bunarët deri te Mulliri, vendosja e gypit shtesë për shkak të rëndësisë që ka nëse është e nevojshme të financohet me mjete vetanake të Kompanisë.

Bordi aprovon Konkluzionin e komitetit të financave që shërbimet përkatëse të vazhdojnë në iniciimin e lëndëve te Përmbaruesi Privat për mos pagesë të faturave të ujit sepse po shihet efekti pozitiv për Kompaninë.

Bordi i Drejtorëve përkrahu projekt propozimin e Kryeshefit Ekzekutiv për punësim njëvjeçar të 50 punëtorëve në departamentin e operatives me pagë mujore 250.00 euro, për tu pranuar falja e borxhit që ka Kompania ndaj MMPH.

Bordi i Drejtorëve aprovoj kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv për shpërblimet e punëtorëve për vit të Ri – 2018, me dhuratë në vlerë 100 euro.

Pas diskutimit për aprovimin e kërkesës për largimin e normativave të kontrolluesve nëpër njësi operative dhe në kuadër të KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a, Nga 7 anëtarët e Bordit sa ishin të pranishëm në takim, 6 anëtar votuan për aprovim të largimit të normativave të kontrolluesve nëpër njësi operative dhe në kuadër të Kompanisë dhe 1 (një) anëtar kundër.

Pasi që votimi ishte me shumë për aprovim, u miratua kërkesa për largimin e normativave të kontrollës nëpër njësi operative dhe në kuadër të KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a.

Bordi i Drejtorëve në takimin e datës 29.12.2017, Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren, përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU "Hidroregjioni Jugor" me: VENDIM pas shqyrtimit të bërë njëzëri miratoi "Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A.- Prizren.

Në këtë takim shqyrtimit të bërë njëzëri miratoi " Planin e furnizimit me ujë në situata të emergjencave dhe Planin për menaxhimin e thatësirave në KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren".

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2017

- Bordi i Drejtorëve gjatë viti 2017 ishte në kontakte të vazhdueshme me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakte direkte por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raporteve tremujore për vitin 2017 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.
- Janë dorëzuar të aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (MZHE); (nga raporti TM1 deri te raporti për TM4), dhe Raporte mujore për ARRU-në;
- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2017 i ka mbajtur 14 takime të rregullta me përbërje të plotë.
- Në kuadër të Bordit të drejtorëve kanë vazhduar të funksionojnë këto komitete;
 1. Komisioni i Auditimit (09 Takime)
 2. Komiteti i Financave (02 Takime)

Bordi i Drejtorëve falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për angazhimin e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët (KFË, Dorsch-CDI), MZHE dhe Kuvendet Komunale për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

Raport vjetor i punës së Komisionit të Auditimit, për vitin 2017.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit, të KRU" Hidroregjioni Jugor" SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Komisionit të Auditimit të realizuara gjatë vitit 2017. Bazë apo burim i të dhënave gjatë përgatitjes së këtij raporti vjetor, janë procesverbalet zyrtare të mbajtura në takimet e Komisionit të Auditimit.

Në bazë të procesverbaleve, për këtë periudhë raportuese janë mbajtur gjithsejt 9 takime të rregullta të komisionit, në të cilat janë diskutuar dhe janë marrë disa vendime. Ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike janë paraqitur të gjitha takimet dhe aktivitetet e Komisionit të Auditimit.

Në takimin e parë të këtij viti, të mbajtur me 25.01.2017, janë shqyrtuar dhe diskutuar disa raporte dhe çështje, sikurse janë:

- Raportimi i vendimeve të B. të Drejtorëve si dhe rekomandimet nga Komisioni i Auditimit për zyrtarët e KRU.
- Raportimi nga Auditori i brendshëm për TM4 si dhe Raportin vjetor 2016.
- Raportimi mbi performancat vjetore të njesive si dhe KRU Hidroregjioni Jugor për vitin 2016.
- Raporti i stoqeve me 31.12.2016.
- Prezentohet kopja e formularit të Deklarimit të TVSH-së për dhjetor 2016.
- Planifikimi i aktivitetëve të Prokurimit në KRU" Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren, gjatë vitit 2017,

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit rekomandon ekipet e kontrollës që të mirret me mbledhjen e borxheve të këqija nga konsumatorët e pandërgjegjshëm, si dhe për kategorinë e konsumatorëve biznese të përgadisnin plan të punës apo të veprimit për gjashtë mujorin e parë të viti 2017.
- Komisioni i Auditimit kërkoj që të gjitha rekomandimet që janë pjesërisht të realizuara sipas raportit, të realizohen në tre mujorin e parë viti 2017.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga menaxhmenti i Kompanisë dhe shërbimi përkatës të përgadisnin plan të veprimit për ndërrimin e ujëmatësve të konsumatorëve në amvisri në një pilotë zonë në njësinë punuese të Prizrenit nga kjo të shihen rezultatet e zvogëlimit të humbjeve në rrjetë të ujësjellësit.

Koha e realizimit të këtij plani të jetë 31.03.2017.

- K.A rekomandon njësinë punuese të Suharekës që të bëjë vendosjen e ujëmatësve në fshatin Mushtishtë dhe koha e realizimit të jetë deri me 31.03.2017.
- K.A rekomandoj udhëheqësit e njesive punuese (Prizrenit, Malishevës, Suharekës dhe Dragashit) që të bëjnë ndryshime e nevojshme në pozitën e punës së punëtorëve tek punëtorët që nuk japin rezultat pune në inkasim dhe kontroll.
- K.A njëzëri Apropoj Raportin e TM4 dhe raportin vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2016.

- K.A pas shqyrtimit të bërë Apropoj raportin e performancës financiare të Kompanisë për TM4-2016 njëzëri.
- K.A vendosi që pasi të dorëzohet raporti final nga Komisioni Qendror për regjistrim të viti 2016 të vendoset në Bord lidhur me korrigjimin e stoqeve të Kompanisë që janë jashtë përdorimit për shkak të vjetërsisë së tyre.
- Gjatë diskutimit nga të pranishmit te përshkrimi i kontratës për furnizim me automjete u kërkuar blerja e një eskavatori pune për njësinë punuese të Malishëvës, te blerja e 10 pikave që planifikuar të ndryshohet dhe të mbetet blerja e 6 pikave.
- Njëherit u kërkuar që planifikimi i kontratave dhe vlera e parashikuar e kontratës për këtë vitë fiskal të jëtë sa më racional dhe sipas mundësive të Kompanisë.
- K.A lidhur me Ankesën e parashtruar nga udhëheqësit e njësive në fjalë mbi Vendimin e Kryeshefit nr.1760 për ndëshkimin e punëtorëve me -10% të pagës, vendosi që kjo Ankesë të shqyrtohet në takimin e radhës të Bordit të Drejtorëve.
- K.A pasi shqyrtoj kërkesën e Udhëheqësve të njësive punuese në Suharekë, Malishevë dhe Dragash për anulimin e Vendimit mbi ndarjen e shpenzimeve rajonale në menyrë proporcionale në bazë të numrit të konsumatorëve Rekomandoj Bordin që të njejtën ta aprovoj dhe shpenzimet rajonale të barten vetëm nga njësia e Prizrenit ngase ka kapacitet kadrovik dhe teknik në nivel shumë më të lartë. Pagesa e shpenzimeve rajonale nga njësia e Prizrenit të evidentohen në një pozicion si shpenzime të veçanta.

Takimi i dytë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 27.02.2017, ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve, sikurse:

- Raportimi i pasqyrave financiare për vitin 2016
- Raportimi nga komisioni për nivelizimin e pagave në KRU Hidroregjioni Jugor
- Raportimi mbi performancat mujore për muajin janar 2017 të Njësive si dhe KRU Hidroregjioni Jugor, si dhe
- të tjera

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit kërkoj nga shefi i kontabilitetit që të jap komente me arsyeshmeri për secilin pozicion kryesor të pasqyrave financiare, komentet të paraqiten në takimin e radhës të Komisionit të Auditimit.
- K.A kërkoj që të mirret shembull organogrami i njësis së Prizrenit edhe nga njësitë tjera punuese, secila njësi të paraqet pozitat aktuale të punës dhe propozimet për ndryshim nese kanë si dhe të përfshihet edhe implikimi buxhetor mujor.
- Komisioni i Auditimit rekomandon që të gjithë koeficientet e punëtorëve që janë ndryshuar gjatë vitit 2016 të kthehen si kanë qenë në dhjetor të vitit 2015, ngase çdo rritje e koeficientëve që është bërë pas kësaj date pa dijenin e Bordit është e panevojshe deri në nivelizim final të pagave.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga Kryetari për nivelizim të pagave që për takimin e radhës të Komisionit të Auditimit të paraqitet kostoja e përgjithshme financiare aktuale dhe e propozuar për secilin grup te punës të paraqitur në raport të nivelizimit të pagave.

Takimi i tretë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 24.03.2017 ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve, sikurse:

- Raportimi i obligimeve ndaj operatorëve ekonomik të ngelur nga viti 2016 dhe obligimet e bëra ne vitin 2017,
- Raport mbi ecurin e arkëtimit të borgjeve të këqija me procedurat përmbarimore.
- Raportimi nga komisioni për nivelizimin e pagave në KRU" Hidroregjioni Jugor"sh.a Prizren.
- Raportimi mbi përformancat mujore për muajin Shkurt të njesive punuese si dhe "KRU Hidroregjioni Jugor"sh.a dhe te tjera.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave, Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit rekomandon sherbimin për konsumator dhe zyren ligjore që të përgadisnin raport përfundimtar për arkëtimin e borxheve të këqija me procedura përmbarimore për maj-dhjetor 2016 dhe janar- mars 2017.

Në raport të veçohen procedurat e udhëhequra në marrëveshje me konsumator, prapsime dhe të përfunduara si tërsi, e gjithë kjo të paraqitet me shumën e parasë së arkëtuar.

- Komisioni i Auditimit autorizon Menaxherin rajonal për Konsumator që të krijoj lista të borxheve të këqija për tri kategorit e konsumatorëve (amvisri, biznese dhe institucione)me shumën e borxhit duke përfshirë borxhin me të lartë që kanë këta konsumatorë deri te borxhi më i ulët.
- Komisioni i Auditimit rekomandoj Bordin e Drejtorëve të aprovoj koeficientët e propozuar për pozitat e punës së punëtorëve të operativës për të gjitha njësit punuese.

Ndërsa për takimin e Bordit të Drejtorëve kërkohet të përgatitet kostoja saktë financiare për kategorin e vendëve të punës të punëtorëve në operativë.

- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të bërë miratoi raportin e përformancës financiare të Kopmanisë për muajin Shkurt 2017, me vërejtje për udhëheqësit e njesive punuese të Kompanisë per vonesë në dërgimin e komenteve sqaruese për caqet e përformancës mujore

Takimi i katërt i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 25.04.2017 ku është bërë:

- Raporti Tremujor i Punës së auditorit të brendshëm (TM1/2017),
- Raportimi mbi performancat financiare (me komente) te TM1 te njesive si dhe KRU Hidroregjioni Jugor.
- Raportimi me pasqyra financiare nga gjirolllogaritë e mirëbesimit te projektëve si dhe të gjirolllogarisë së ndërmarrjes.
- Shqyrtimi i Deklaratës për politiken e Kompenzimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU"Hydroregjionit Jugor " sh.a,Prizren.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj Raportin e TM1 të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2017. K.A kërkoi që rekomandimi i Auditorit të Brendshëm të respektohet nga Departamenti i Financave dhe zyrtarët që e hartojnë dhe revidojnë Plan Biznesin.
- Komisioni i Auditimit pas aprovimit të bërë kërkoj nga Menaxhmenti i Kompaniasë që të respektohen dhe implementohen të gjitha rekomandimet e dalura nga Auditori i Brendshëm nëpër raportet e auditimit të bëra në TM1-2017.
- Komisioni i Auditimit kërkoj që të mirren masa ndaj Udhëheqësit njësisë punese të Suharekës me bashkëpunëtor, për shkakë të përformancës negative për tre muaji me radhë.
- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të bërë Aprovoj raportin e përformancës financiare të Kopmanisë për TM1-2017, me vërejtje që komentet nga shërbimet përkatëse të dorëzohen me kohë ashtu si kërkohen nga ZLR.
- K.A aprovoj Deklaratën për politiken e Kompanzimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU"Hydroregjionit Jugor "sh.a dhe të njejtën propozon të aprovoj edhe Bordi i Drejtorëve.

Takimi i pestë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 26.05.2017 ku është diskutuar:

- Regjistri i inkasimit të borxhëve të këqija 2009 deri 2016 sipas Ligjit për faljen e borxheve,
- Regjistri i borxhëve të keqija sipas konsumatorëve për vitin 2016,
- Treguesit e përformacës financiare, Prill 2016, si dhe
- Forma për përgaditjen e planit të Biznesit.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit rekomandon shërbimin për konsumator që secili konsumatorë që ka borxhë duhet patjetër të punohet në drejtim që të binden të paguajnë diçka për shërbimet e ujësjellësit për arsye se mos të kaloj në borxhë të keq sidomos në këtë gjashtë mujorin e parë të këtij viti.
- K.A rekomandon që komunikimi ndërmjet Komisionit të Auditimit dhe Zyrtarëve të lartë të Kompanisë "HRJ" të bëhet në formë zyrtare ku për secilin dokument relevant Zyrtari i cili e ka përgaditur raportin të merr përgjegjësi duke e nënshkruar dhe protokoluar raportin në fjalë.
- K.A rekomandon shërbimin e financave që duke u bazuar Ligjet që rregullojnë fushën e financave të përpilohet rregullore për provizionimin e borxhit të keq apo të arkëtueshmeve.
- K.A rekomandoj shërbimin e financave që për takimin e radhës së Bordit të drejtorëve të paraqitet regjistri i borxhëve të keqija sipas konsumatorëve për vitin 2016.
- K.A kërkoj nga shërbimi i financave që për takim të Bordit të paraqitet regjistri i rritjes së pagave për muajin Prill 2017 në krahasim me muajin paraparak.

Takimi i gjashtë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 26.07.2017, ku janë shqyrtuar:

- Aktivitetet rreth faljes së borxheve sipas ligjit për faljen e borxheve, Janar- Qershor 2017,
- Raporti i rastëve të proceduara tek Permbaruesit privat për konsumatorët borxhlinjë për Janar- Qershor 2017,
- Raporti i përformacës financiare për Qershor dhe TM2- 2017.
- Raporti njoftues rreth revidimit të Planit të Biznesit,
- Shqyrtimi i raporteve të Auditorit të Brendshëm.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- K.A pas shqyrtimit të bërë të raportit për falje të borxhëve i bëri vërejtje gojore Menaxherit rajonal për konsumator për vlerën jo të sakt të paraqitur të shumave totale të inkasuar.
- Poashtu kërkoj nga shërbimi për konsumator të korigjohen raportet e faljes së borxheve të TM1, TM2 dhe raporti gjashtë mujor dhe të paraqiten vlera të sakta që kanë përputhje në mes të raportëve.
- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të bërë kërkoj që të vazhdohet me procedimin e lëndëve të përmbaruesi privat të gjithë konsumatorët që kanë shumë më të mëdha të borxhit.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga menaxhmenti i lartë i Kompanisë që të filloj me procedurat e implementimit të planit të biznesit në baza mujore sipas modulit të përgaditur nga Zyrtari i lartë për raportim.
- Komisioni i Auditimit kërkoj që të gjitha rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm në raportet e auditimit të shërbimeve përkatëse të iu dërgohen departamentëve përkatëse dhe të implementohen me kohë.

Takimi i shtatë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 25.08.2017, ku është shqyrtuar:

- Raport nga zyrtari i prokurimit për ecurinë e aktiviteteve për vitin 2017
- Raport nga zyrtari për konsumator, për konsumatorët që nuk kanë paguar mbi 6 muaj, (të përgatitet një raport me shkrim mbi aktivitetet që i bëjnë akteret në terren) për gjithë kompaninë,

- Rishikimi i koeficienteve të zyrtareve të kompanisë në të gjitha digasteret.
- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të Kompanisë, korrik 2017.
- Të tjera

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- K.A i rekomandon Bordit të Drejtoreve që të ndryshohet vendimi i Bordit të Drejtoreve me Nr. të protokolit 264. i datës 11.03.2016. Komisioni i Auditimit propozon që aprovimi për çdo aktivitet nga Zyra e Prokurimit të merret në bazë të kontakteve me email që ka Komisioni i Auditimit dhe Zyra e prokurimit.
- K.A rekomandon që të vazhdohen kontratat me mediat lokale me qëllim të informimit sa më të saktë të konsumatoreve nëpër njësitë punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren.
- K.A rekomandon Bordin e Drejtoreve që limiti i inkasimit të rritet nga 80% në 90%, ndërsa nga kontrolla deri më 31.12.2017 propozoi që të nxjerrin 20% e vleres së borxhit total për konsumatorët që nuk kanë paguar mbi 6 muaj (janar-qershor 2017).
- K.A rekomandon Menaxherin Financiar së bashku me ekipin e financave që deri në takimin e ardhshëm të Komisionit të Auditimit të përgatitë një plan të veprimit për stimulim që element bazë për rritje të hyrave të jenë ekipa e kontrolles dhe limiti i inkasimit
- K.A gjegjësisht R.Abazi propozoi që të përpilohet Rregullorja mbi provizionimin e llogarive të arkëtueshme duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ 14/2010 dhe 2/2016, të bëhet një kriter për llogaritjen e borxheve të këqija.

Takimi i tetë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 25.09.2017 ku është bërë:

- Raport i faljes së borxheve përfundimisht për vitin 2017,
- Raport mbi procedurat e inicuarat te përmbaruesi privat për inkasimin e borxheve për muajin Gusht 2017,
- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të Kompanisë, Gusht 2017,

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime: ---

Komisioni i Auditimit për takimin e radhës së Bordit të Drejtoreve kërkoj nga Menaxheri Rajonal për konsumator të përgatit raport për të tri kategoritë e konsumatorëve që kanë borxh mbi 1000€, si dhe të përgatit listën e konsumatorëve që kanë kontratë për pagesë të borxhit por nuk i përmbahen dhe konsumatorët që nuk kanë paguar fare gjashtë muajit e fundit.

Komisioni i Auditimit kërkoj që për lëndët e përfunduara përmes Përmbaruesit Privat të shtohet ne raport sa është shuma e borxhit të inkasuar për vitin 2017.

Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të bërë miratoi raportin e performancës financiare të Kompanisë për muajin Gusht 2017.

Shqyrtimi i Vendimit mbi përcaktimin e normës për llogaritjen e të ardhurave personale mujore të Inkasantëve dhe, Vendimi për normativin, stimulimet në të ardhurat personale për ekipet e kontrollës dhe ç'kyçje ne KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren.

Pas diskutimit të bërë lidhur me përcaktimin e normës për llogaritjen e të ardhurave personale mujore të Inkasantëve, Komisioni i Auditimit aprovoj që norma e limitit të inkasantëve të rritet për 10% për bazën paraprake, stimulimi të jetë 15% dhe destimulimi të jetë 5%.

Pas diskutimit të bërë Komisioni i Auditimit aprovoj propozim vendimin të Menaxherit Rajonal për konsumator për normativin, stimulimet në të ardhurat personale për ekipet e kontrollës dhe ç'kyçjes ne KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a, ku parashihet normativi për kontrollën e njësisë së Prizrenit 7.000€ euro inkasim nga lista e konsumatorëve borxhlinj , për Suharekë dhe Malishevë nga 3000€ dhe për Dragashin 1000€.

Takimi i nëntë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 22.12.2017 ku është bërë:

- Të prezantohet deklarata e TVSH-së (fotokopjet) për muajin Tetor dhe Nëntor për vitin 2017,

- Raport mbi auditimin e zyrës së Prokurimit për të gjitha aktivitetet në vitin që po e lajm pas që të shohim se si janë me afatet kohore ,
- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të Kompanisë për Nëntor 2017,
- Shqyrtimi i planit vjetor për 2018 dhe planit strategjik të punës së Auditorit të Brendshëm për 2018-2020,
- Shqyrtimi i raportit të punës së Auditorit të Brendshëm për TM3-2017

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit kërkoj nga Udhëheqësi i njësisë së Malishevës raport sqarues për mos mbulim operativë për tre muajt e fundit (shtator,tetor,nëntor-2017), raporti të paraqitet ne takimin e radhës të BtD.
- Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj Planin strategjik i punës së auditorit të brendshëm, për periudhën 2018-2020 dhe Planin Vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2018.
- Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj Raportin e TM3 të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2017.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga shërbimet përkatëse që rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm në raportet e prezantuara të implementohen me kohë.

3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

3.1.1 Aktivitetet nga Shërbimi Teknik - 2017

- * Takime ditore me Kryeshefin Ekzekutiv.
- * Takim në DSHP për shpronsimin e 11 parcelave për ITUZ.
- * Kontakt në telefon me Kadri Selimaj për procedurat e ITUZ.
- * Takim me CDI-në për objektivat e 4 vjeçarit të ardhshëm.
- * Drek pune me CDI-në, Dorsch, KKP deputeten Emilja Rexhepi për zonen e Zhupes.
- * Takim me perfaqesuesit e Aktualis për kompletimin e klemave – vonesat për Fazen II të projektit për ITUZ.
- * Konfirmimi për takimin me kompanin Dorsch për projektin e asistences teknike i cili do të mbahet me 08.02.2017.
- * Dalje në teren për verifikim të punetoreve të ekipës së ujërave të zeza.
- * Kontroll e kaperderedhesit tek Ralini.
- * Kontakt në telefon me perfaqesuesin e konsulences Kadri Selimaj për qeshtjen e pagesave dhe në përgjithësi për Fazen I të projektit.
- * Takim me inxhinierat dhe grupin e ujërave të zeza në zyre të kompanisë.
- * Takim me konsulencën me këtë agjend:
 - Shqyrtimi i klemave
 - IPC – 6
 - Adendumi i P2M-se
 - VO – 5
- Në të gjitha këto pika u dakordua që të përgaditen të gjitha dokumentet nga ana e konsulences dhe të sjellën për miratim në HRJ.
- * Takim me DSHP për shqyrtimin e menyres së procedimit të projektit të financuar nga KKPz, Shpat-Dardani.
- * Takim me Kryesusin e Kuvendit të Prizrenit për shqyrtimin e objektit administrative të HRJ.
- * Bised në telefon me Afrim Demirin për takimin me sekretarin e MMPH – se për qeshtjen e 11 parcelave.
- * Bised në telefon me Mollnarin dhe me Arbenin për procedimin e dokumentacionit të pagesave për Fazen I dhe kllemat për Faze II.
- * Vizit në Vlashje për inspektimin e humbjeve të ujit.
- * Dergim për miratim për klema në KFW për Fazen II për projektin e ujërave të zeza.
- * Dorzimi i amendmentit nr. 4 tek Ulhriu nga P2M për projektin e ujërave të zeza.
- * Takim me perfaqesuesin e Kshillit Gjyqesor për sanimin e defektit në kanalizim në objektin e Gjykatës Themelore.
- * Takim në MMPH me temën:
 Aplikimi për pelqimin e miratimit të fillimit të projektit.
 Dokumentet për zonen e III-të mbrojtëse tek 40 burimet.
 Alukimi i mjeteve nga ana e ministris për projektin e ujërave të zeza për vitin 2017.
 Vendimi i Qeverisë për shpronsim të 11 parcelave të cilat gjenden mbrenda lokacionit ku do të ndërtohet ITUZ-ja dhe janë në pronesi të KBI-Progres.
- * Miratimi i ndrrimit të gypit dhe dërgimi i këti miratimi tek Konsulenca dhe KfW.
- * Përpilimi i miratimit të takimit në MMPH dhe dërgimi tek Konsulenca.
- * Vizit tek vendpunishtja të Gjykata Themelore.

- * Takim me Kryetarin e Gjykatës.
- * Takim me Prokurorin për qeshtjen e zonave rurale.
- * Takim me Lavdim Osmanaj për zonat mbrojtëse.
- * Takim me Ministrin Mahir Jaghillar.
- * Dërgimi i tabelave sëpagesave në MMPH të Agim Radoniqi për projektin e ujërave të zeza.
- * Kontakte në telefon me Premtim Ismajlin në lidhje me pagesat e Aktualis për FAZ II
- * Dërgimi i rikujtimit në KfW për miratim të Kllemave.
- * Dërgim në MZHE i marveshjes financiare dhe marveshjes së veçant për proj. e ujërave të zeza..
- * Dalja në teren në lagjen Kurilla për inspektim të grupit të ujërave të zeza dhe verifikim të defektit në ujësjellës.
- * Takim në Qeveri me kshillin ndërministror.
- * Drek pune në Emerald si dhe pjesëmarrës në konferenc e mbajtur nga MZHE.
- * Përgaditja e raportit të prodhimit për muajin Gusht dhe dërgimi i raportit në ARRU.
- * Aplikim për pelqim në DSHP për qasje në rrugë lokale për kabell elektrike.
- * Takim në Tirane me investitorët Italian dhe Slloven për mbeturina.
- * Takim në MZHE me Adem Ahmetajn për lirimet nga Dogana dhe takim me Agim Thaqin për projektin e mbetur në qender të qytetit të Prizren-it.
- * Takim me investitorët Italian dhe Slloven në zyret qendrore të Kompanisë.
- * Takim me DORSCH për aranzhimin e aktiviteteve të Asistencës Teknike.
- * Takim me Konsulencën për rregullimin e dokumenteve si përgjigje për Puherin e KfW.
- * Dërgimi i kërkesave të Adem Ahmetaj për lirim nga taksat dhe përpilimi i kërkesës për rimbursimin e doganës dhe tvsh për kontingjentin e parë.
- * Përpilimi i sqarimit në MZHE për automjetin e blerë.
- * Njoftim Kelmanit për dëgimin e njoftimit në MZHE.
- * Dërgimi i kërkesës numër 9, 10 dhe 11 për no objection në KfW, AQUALIA.
- * Takim me Sulltanin, diskutimi i pagesave shtese dhe letrës nga KfW, si dhe rruga Sangjakut.
- * Takim me ALFA I dhe XERXA për vazhdimin e projektit në qendren e qytetit.
- * Takim javor me Konsulencën dhe kontraktorin PASSAVANTE, progresi i punimeve Fazën 1.
- * Takim në AKK me temën ndryshimi dhe te rejtat për Deklarimin e rregullt të pasurisë për zyrtarët e lartë.
- * Takim me udhëqesin e projektit Masat Shoqërore, për informacionet në Departamentin Teknik, si Organogrami, rregulloret dhe zbatimi i tyre, organizimi i punës, organizimi i sektoreve brenda departamentit, etj.
- * Inspektim në vendin e punimeve në fazën 1 dhe Fazën 2 të projektit të ujërave të zeza.
- * Takim në MZHE, ku u dorëzua dokumentacioni për Lirim nga Dogana dhe TVSH-ja për kontingjentin e parë të Fazës 2 të projektit të ujërave të zeza.
- * Takim në MZHE, ku u dorëzua dokumentacioni për Lirim nga Dogana dhe TVSH-ja për kontingjentin e fundit të Fazës 1 të projektit të ujërave të zeza (shkallet e pusëve dhe interceptoreve).
- * Takim me menaxherët e departamenteve për përpilimin e planit të biznesit dhe aplikimin tarifor për vitet 2018-2020.
- * Takim me udhëqesin e projektit Masat Shoqërore, në lidhje me ecurinë e projektit dhe shqyrtimi i Draftit për Raportin fillestar i cili pritet të dorëzohet si final dhe pastaj të dërgohet në KfW për miratim (për me gjerësisht raportojnë Lulzim Paçarizi dhe Lumni Sallahu).
- * Takim në Këshillin ndërministror si grup i menaxhimit të ujërave të zeza me temën prezantimi i progresit të projektit të Impiantit në Prizren si dhe diskutimi në lidhje me sfidat gjatë realizimit të projektit të ujërave të zeza në Prizren.
- * Inspektimi i punimeve në projektin e rehabilitimit të gypit transportues në qendren e qytetit, projekt ky i financuar nga MZHE.
- * Dërgimi i formulareve për Deklarimin e pasurisë në AKK.
- * Dërgimi i kërkesës në Ministrinë e Bujqësisë për ridentimin e tokës për 11 parcelat të cilat me vendim të qeverisë tani me janë prone e Komunes së Prizrenit,

- *Dergimi i vendimit per ridestinim ne MMPH per plotesimin e kushteve per leshimin e kushteve ndertimore nga MMPH,
- *Marrja e kushteve ndertimore nga MMPH per projektin e ujerva te zeza ne qytetin e Prizrenit.
- *Takim me Drejtorin e DSHP-se Sulltan BADALLI per ecurine e projektit te furnizimit me uje te pijes te lagjes Dardania nga rezervoari Shpati, pas konkluzionit te nxjerre nga Komuna e Prizrenit per financimin e ketije projekti ende nuk eshte shpallur tenderi nga ana e Komunes se Prizrenit.
- *Shqyrtimi i rregulloreve te miratuara nga ARRU dhe mundesia e implementimit te tyre.
- *Takim ne ARRU per diskutimin dhe aranzhimin e aplikimit te rregullt tarifar per vitet 2018-2020, ku perpos menaxhmentit te kompanise pjesemarres ishin edhe perfaqesuesit nga DORSCH si konsulente e projektit Masat Shoqeruese.(me gjeresisht raportin zyrtari per Plan Biznes F.B).
- *Takim me banoret e lagjes se fshatit Gjonaj ne vendpunishte per ecurine e projektit ne fshatin Gjonaj te financuar nga MMPH, ku u konstatua se banoret e kesaje lagje ne menyre te drejteperdrejte pa kurrfar te drejte jane duke e penguar implementimin e ketije projekti. (per raportin e progresit te punimeve per kete projekt raportin mbikqyresi Urim Selimaj).
- *Takim me Delegacionin e Qeverise Gjermane, Bankes Gjermane per Zhvillim-KfW dhe perfaqesuesit e ambasades Gjermane ne lokacionin ku eshte duke u ndertuar Impianti per Trajtimin e Ujerave te Zeza, me crast permes prezantimeve u raportuan performancat e kompanise nder vitet, aksesit i investimeve Gjermane ne ngritjen e performances se Kompanise, rendesia e Projektit te Ujerave te Zeza ne aspektin ambiental, metoda e funksionimit te ITUZ-se per Prizren dhe progresi i punimeve per komplet projektin e Ujerave te zeza (Faza 1 dhe Faza 2) te bashkfinancuar nga Qeveria Gjermane permes KfW-se.
- *Ridergimi ne MZHE i kerkeses per financimin-rialokimin e mjeteve per projektin e Rehabilitimit te rrjetit ne rruget qendrore te Prizrenit, konkretisht (ndrrimi i rrjetit furnizues nga Bunari 1 neper qendren e shadervanit deri te kisha Katolike).
- *Dergimi i te dhenave sipas kerkeses se Burbuqe NUSHI nga IKShP.
- *Pjesemarrje ne evaluimin e tenderit per 4 automjetet sipas tenderit te udhehequr nga zyra e prokurimit, ne cilesine e kryetarit te komisionit.
- *Ridergimi i kerkeses ne Ministrine e Infrastruktures per dhenien e pelqimit qe autostrada nuk bie ndesh me Impiantin e trajtimit te Ujerave te Zeza.
- *Mbkedhja e rregullt e menaxhmentit te kompanise, mbi aktivitetete ndermarra per furnizimin e rregullt te konsumatoreve me uje te pijes dhe me sherbime te kanalizimit.
- *Dergimi i kerkeses ne DSHP-Prizren, per mundsine e takimit me vanoret e parcelave ne te cilat do te kaloje linja e gypit shkarkues nga ITUZ deri ne lumbardh.
- *Dergimi i pergjigjes per ELKE, ne lidhje me kerkesat e saje per projektin e ujerva te zeza ne qytetin e Prizrenit Faza 1 dhe Faza 2.
- *Leshimi i Lejes se ndertimit nga MMPH per Projektin e Ujerave te Zeza ne Prizren,
- *Perpilimi raportit per muajin MAJ 2017.
- *Takim me konsulencen dhe PASSAVANTIN per progresin e inspektimit te kolektorit kryesor,
- *Miratimi nga ana jone per prezencen e ekspertit nga KfW per verifikimin e shpronësimit te lokacionit per ndertimin e ITUZ-se.
- *Takim me perfaqesuesin e institutit arkeologjik Shafi Gashin per punimet arkeologjike te cilat jane duke u zhvilluar brenda lokacionit ku do te ndertohet ITUZ-ja.
- *Komentet ne dokumentacionin parakualifikues per Fazen V te inspektimit te rrjetit te kanalizimit per Prizren, Gjakove dhe Peje, te financuar nga KfW.
- *Miratimi i Raportit Fillestar per projektin e Masave Shoqeruese-Asistences Teknike, raporti eshte miratuar nga ana jone, mirpo KfW ka komentuar ne kete raport, i mbetet konsulences se projektit qe te rishqyrtoj komentet dhe raporti fillestar te behet final dhe te dergohet perseri per miratim ne KfW.
- * Kontrollimi dhe komentet ne dokumentacionin parakualifikues per projektin „Shkatërrimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore, Faza V, Peje, Gjakove dhe Prizren“.

- * Takim me banoret e fshatit Zhur mbi percaktimin e vijes ku do te kaloje gypi shkarkues nga ITUZ ne Lumbardh. Si konkluzion nga ky takim doli qe nga Gjeodete tane te matet vija-hapesira ku do te kaloje ky gyp.
- *Dhenia e komneteve per aplikantet te cilat kane konkuruar ne projektin Shkatërrimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore, Faza V.
- * Takim i menaxhmentit dhe pergjegjesit per aplikim Tarifor, ku jane diskutuar te dhenat te cilat deparamenti teknik i ka vendosur ne planbiznesin rregullator.
- * Pjesemarrje ne Workshop-in per GIS, te cilin e ka organizuar Konsulenti DORSCH per projektin e Masave Shoqeruese-Asistenca Teknike.
- * Diskutimin dhe shqyrtimin e dy shkresave te ARRU-se drejtuar KRU-ve permes letres qarkore ne te cilen eshte specifikuar dorezimi i Plan Biznesit Rregullator, perpilimi i strategjise se furnizimit me uje ne situata emergjente dhe plani i menaxhimit te asetëve, per me gjerfesisht do te gjeni rraportet tek udhehesit perkates, Lulzim Paçarizi, Lumni Sallahu dhe Isret Fondaj.
- * Takim me Richard Ellert, tender agent i caktuar nga KfW-ja per projektin e ujerave te zeza faza V projekt I perbashket I Pejes, Gjakove dhe Prizrenit, ne kete takim u prezantua gjendja ekzistuese e sistemit te kanalizimit per qytetin e Prizrenit, u prezantua progresi punes te cilen ekipa e vecant e ujerave te zeza ka ndermarre ne formimin e kadatres se sistemit te ujerave te zeza, si dhe u percaktuan nevojat kryesore te investimeve ne sistemin e kanalizimit per qytetin.
- * Takim me kryetarin e Komunes Ramadan Muja, per mundesine e mbulimit te kostos per germime arkeologjike te cilat i ka zhvilluar IAK ne lokacionin ku eshte duke u ndertuar ITUZ-ja,
- *Dergimi i kometeve nga ana jone ne lidhje me Raportin Fillestar per projektin M. Shoqeruese.
- *Permbyllja e projektit per rehabilitimin e kaptazhes ne CVILEN dhe dorezimi i dokumentacionit te rregullt tek departamenti i Financave.
- * Takim me drejtorin e sherbimeve publike ne lidhje me implemetimin e projektit per lagjen Dardania, kuriilla, bazhdarhane dhe 2 korriku.
- *Vizite ne Dobrushte, per progresin e punimeve ne projektin rregullimi i kaptazhes dhe shtimi i sasise se ujit per fshatin Dobrusht.
- *Takim javor me Konsulencen dhe kontrfaktorin e fazes 2 mbi progresin e punimeve,
- *Kontrollimi teknik dhe sanimi i verejtjeve te mundshem ne kolektorin kryesor qe i perket Fazes 1 te projektit te ujerave te zeza.
- *Dalja dhe inspektimi i punimeve ne te gjitha projektet te cilat jane ne vijim dhe pritet te perfundojne gjate vitit 2017.
- *Takim i rregullt mujor me kontraktoret e fazes 1 dhe fazes 2 dhe konsulencen, te projektit te ujerave te zeza ne Prizren.
- * Miratimi perfundimtar nga ana jone per 5 kompanite parakualifikuese dhe dergimi ne MZHE, si pjesemarrjes ne komisionin per evalumimin e pjeses parakualifikuese per projektin e rehabilitimit te sistemit te ujerave te zeza te financuar nga KfW-Faza e V-te.
- * Plotesimi, kontrolli dhe pershtatja e perdes se investimeve ne Planbiznesin rregullator per aplikimin e rregullt tarifor 2018-2020.
- * Shikimi i Termave te references per projektin e rehabilitimit te sistemit te ujerave te zeza te financuar nga KfW-Faza e V-te.
- * Pjesemarrje ne Workshop-in per Menaxhimin e Llumit, te cilin e ka organizuar Konsulenti DORSCH per projektin e Masave Shoqeruese-Asistenca Teknike, Projekti i ITUZ-se.
- * Takim me perfaqesuesit e Konsulences, Kontraktorit AQUALIA&Hidroterm, per diskutimin lidhur me vonesat per shkak te arkeologjise, ku dhe eshte diskutuar mundesia e pagesave shtese per vonesa.(per me gjeresisht ekzistojne minutat e takimit ne mes paleve).
- *Takim me perfaqesuesit e Institutit Arkeologjik, dhe nenshkrimi i Marreveshjes per pagesat e punimeve te zhviluara nga instituti si dhe lejimin e punimeve ne lokacionin ku eshte duke u ndertuar ITUZ-ja.
- *Permbyllja e projektit per rehabilitimin e kaptazhes ne DOBRUSHT (Faza 1 e germimeve) dhe dorezimi i dokumentacionit te duhur tek departamenti i Financave.

*Pergaditja e dokumentacioneve te kerkuara per takimin me delegacionin e Bankes Gjermane, me temen procesimi implementimit te projektit te Ujerave te Zeza ne Prizren. Pjesemarrjes ne kete takim ishin Elke Dulenkopf dhe Michel Pucherf.

* Pjesemarrje ne konferencen e DANUBIT ne RUMANI, ne lidhje me trajtimine ujerave te zeza te cilat derdhen ne lumin DANUB.

*Vizite nga delegacioni Gjerman ne perberje prej Qeverise Gjermane, Ambasades Gjermane ne Kosove dhe bankes gjermane ne Prishtine, Tema e viztes, investimet e reja nga Qeveria Gjermane dhe progresi i punimeve per impiantin e ujerave te zeza.

* Prezantimi i Planeve per menaxhimin e furnizimit me uje te pijes ne situata emergjente dhe menaxhimin e Thatesirave, para Bordit te Drejtoreve, ku te njejtat jane miratuar nga Bordi i drejtoreve.

* Dergimi i IPC10 dhe 11 ne MMPH, per pagesat e situacioneve per muajin 11 dhe 12 te vitit 2017, IPC nr. 11 nuk eshte paguar plotesisht per shkak te sistemit ne MF, ne kete fature kan mbetur borgj 900.00 Euro.

* Dalja dhe inspektimi i punimeve ne te gjitha projektet te cilat jane ne vijim dhe pritet te perfundojne gjate vitit 2017.

* Takim i rregullt mujor me kontraktoret e fazes 1 dhe fazes 2 dhe konsulencen, te projektit te ujerave te zeza ne Prizren, saktesisht projekti i ndertomit te ITUZ-se.

* Takim me konsulencen e projektit Masat Shoqeruese.

* Projektet e financuara nge Qeveria Zviceriane dhe projektit te Eficiences se Energjise Elektrike te financuar nga KfW, raportet perkatese jane proceduar nga Menaxheret e ketyre projekteve Zenel Zenelaj dhe Aranit Ukimeri.

*Takim pune me udheheqesit e departamenteve per kontrollin dhe analizen e procesit tarifor 2018-2020.

*Formimi i komisionit per hartimin e strategjise per zvogelimin e humbjeve te ujit, kerkese kjo nga MZHE dhe keshilli nderministror i ujerave.

*Pjesemarrje ne takimin e organizuar nga levizja EC me Ndryshe me temen Qytetet gjithperfishirese.

*Takim me komisionin per Hartimin e Statgjise per zvogelimin e humbjeve te ujit, ku pjesmerres ishin edhe Udheheqesit e Njesive Operative te cilet u njoftuan me detyrat e percaktuara nga ky komision.

3.1.2 Aktivitetet nga Shërbimi Teknik për eliminimin e humbjeve teknike

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
- ✚ Sensibilizimin e te gjithe konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithe konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

3.1.3 Planifiki i investimeve emergjente

(shiko planifikimin e investimeve)

3.1.4 Prodhimi i ujit m3

Prodhimi i ujit m3 - Janar-Dhjetor, 2016

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	13,534,849.00	36,980.46	428.0	
Suharekë	2,052,541.00	5,608.04	64.9	
Dragash	410,758.00	1,122.29	13.0	
Malishevë	1,373,065.00	3,751.54	43.4	
Total	17,371,213.00	47,462.33	549.30	

Prodhimi i ujit m3 - Janar-Dhjetor, 2017

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	12,900,866.00	35,344.84	409.1	
Suharekë	2,210,835.00	6,057.08	70.1	
Dragash	963,848.00	2,640.68	30.6	
Malishevë	1,406,876.00	3,854.45	44.6	
Total	17,482,425.00	47,897.05	555.9	

3.1.5 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar-Dhjetor, 2016

Njësia Operative	Ujësjetllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1550	815	2365
Suharekë	253	127	380
Dragash	47	25	72
Malishevë	500	69	569
Total	2.350	1.036	3.386

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar-Dhjetor, 2017

Njësia Operative	Ujësjetllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	2171	1018	3189
Suharekë	353	84	437
Dragash	64	20	84
Malishevë	490	93	583
Total	3.078	1.215	4.293

3.1.6 Zyra për planifikim dhe zhvillim – Janar - Dhjetor / 2017

Për periudhen që po raportojme në kuader të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në teren kanë vazhduar bllombimet e ujëmatësave nëpër qytetin e Prizrenit dhe atë në hartat:

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	<i>Bllombim-Kontrata</i>	1112
2	<i>Ribllombim</i>	865
3	<i>Dera Mbyllur(Heren e dyte)</i>	3716
4	<i>Pa ujemates</i>	261
5	<i>Konsa te gjetur</i>	828
6	<i>Rekurde te reja</i>	443
7	<i>Rekorde me konsa</i>	85
8	<i>Rekorde</i>	2376
9	<i>Regjistrim i ri</i>	31
10	<i>Duhet regjistrim</i>	60
11	<i>Në ndërtim</i>	110
12	<i>Lidhje uji jo</i>	614
13	<i>Kerkesa nga konsumatorët</i>	45
14	<i>Refreshim</i>	09
15	<i>Jane te bllombuar</i>	123
16	<i>Bllombime</i>	68
17	<i>Ndrim i vendit të rekordit</i>	74
18	<i>Konsumatorët me ujëmatësa</i>	112
19	<i>Paushall</i>	02
20	<i>Ndërrim i konsit.</i>	02
21	<i>Konsumatorë të verifikuar</i>	269
22	<i>Vend i papërshtatshem</i>	02
23	<i>Zevendesim</i>	31
24	<i>Germadha</i>	208

AKTIVITETET KRYESORE

* Përpilimi i raportit Janar - Dhjetor , 2017.

* Fshati Gelanc – Suharekë aktivitetet: Kontrata bllombime 207; lidhje uji jo 28; rrjedhje te ventili 02; puseta me uje 02; lidhje uji jo, bllombim po 06; kontrata jo, bllombim po 48; kontrata jo, bllombim jo 04; dera mbyllur 18.

* Regjistrimi i materialit në depot e njësive të KRU”Hidroregjionit Jugor”Sh.A.

* Formimi i grupit për verifikimin, inqizimin dhe digjitalizimin e rrjetit të kanalizimit për qytetin e Prizreni-it.

* Takim pune në SHUKOS me datë: 27.02.2017.

* Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i hidrantave nëpër qytetin e Prizrenit”, Prizren.

* Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në qender të qytetit të Prizren-it”.

* Takim pune në SHUKOS si dhe ligjerata e mbajtur me datë:16.03.2017, e organizuar nga Profesionistet e Rinj të Ujit në bashkepunim me FNA, për nderë të shënimit të D.B. të Ujit.

* Njesia Suharekë, fshati Leshan: Kontrata dhe bllombime 95, rekorde 169, lidhje uji jo 14, dhe që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 25 konsumator.

* Takim pune nga të gjitha KRU-të për Planin e Furnizimit me Ujë në Situata Emergjente.

* Regjistrim në fshatin Medvec, Prizren: Kontrata bllombime 86, rekorde 241, lidhje uji jo 136 dhe kontrata jo bllombime po 19.

* Njesia Suharekë, fshati Leshan: Kontrata dhe bllombime 159, rekorde 281, lidhje uji jo 49, gërmadha 04, D.M - kontrata jo bllombime po 18, dhe D.M 51 konsumator.

* Njesia Suharekë, fshati Tërrnje: Kontrata dhe bllombime 120, rekorde 203, lidhje uji jo 38, D.M - kontrata jo bllombime po 41, dhe D.M 04 konsumator.

* Punime në projektin “Rehabilitimi i kaptazhës në Gjonaj të Hasit”.

* Trajnim për menaxhimin e humbjeve në Prishtinë.

* Fshati Zojz: kontrata – bllombime 92, pa ujemates 40, kons.qe don me u ç`lajmru 01, lidhje uji jo 15, nuk pranon 01, dera mbyllur 37.

* Lagja Arban: kontrata-bllombime 61, bllombime po-kontrat jo 2, pa ujemates 20, regjistrim 22, lidhje uji jo 57, nuk pranojne 7, per shkak te kushteve 8, ne ndertim 52, regjistrim i kontrolles 23 dhe D.M 57.

* Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në zonar rurale”, Prizren.

* Takim për planin e Menaxhimit të thatsirave në Prishtinë.

* Pjesmarrje në Konferencen e ujërave në Prishtinë.

* Takim pune për planet: Menaxhimin e thatsirave dhe Furnizimi me ujë në situata të emergjencave të mbajtur në Prishtinë.

*Gjatë muajve Janar - Dhjetor grupi i kanalizimit ka vazhduar me perpunimin e te dhenave te terrenit, vendosjen e te dhenave ne GIS gjegjesisht formimin e atributiveve per gypa kanë përfunduar te gjitha zonat në sektorin e kanalizimit dhe puseta janë përfunduar:

1. Formularët për çdo pusete në formë elektronike dhe hardcopy,
2. Tabela e atributiveve për gypa të kanalizimit,
3. Tabela e atributiveve për puseta,
4. Tabela e atributiveve për pikat shkarkuese,
5. Struktura e bazës së të dhënave.

Keto te dhena jane strukturuar ne databazen e konfiguruar ne serverin e kompanise ku secilit perdorues te GIS-it ju eshte mundsuar qasja ne databaze si dhe ne hapesiren punuese QGIS, keto dy hapesira jane te nderlidhura mes vete gje qe ka mundsuar perfshirjen e shume perdoruesve ne te njejten kohe.

Gjithashtu eshte punuar edhe ne tabelen O&M (Operim dhe Mirembajtje) ku jane vendosur atributet e nevojshme per funksionimin e kesaj tabele.

Pas grumbullimit te te dhenave nga tereni dhe futja ne databaze dhe GIS pritet te funksionalizohet edhe tabela e Operimit dhe Mirembajtjeses ku pritet te vendosen rekordet e reja.

Grupet e terrenit kane vazhduar me inspektimin e pikave shkarkuese ne cdo zone, ku keto pika jane vendosur ne QGIS me te gjitha karakteristikat.

Gjatë këtyre muajve grupi i kanalizimit ka vazhduar me inspektimin e rrjetit të ujësjellësit gjegjesisht formimin e atributiveve dhe vendosjen në GIS.

1. Formulimi i atributiveve për gypa,
2. Formulimi i atributiveve për valvula,
3. Formulimi i atributiveve për nyje.

Këto të dhëna janë duke u plotësuar çdo ditë nga ekipi i terrenit ku secila nyje, valvule do të ketë formular të veçante me karakteristika të veta.

Gjatë inspektimit të këtyre zonave kemi hasur në rrjedhje të ujit ku dyshohet si ujë i pijes, të cilat i kemi identifikuar, lokalizuar 53 raste (dyshime) dhe i kemi paraqitur në hartë, së bashku me ekipin e detektimit i kemi detektuar dhe me ç`rast kemi gjetur defekte, kemi njoftuar Drejtorin Teknik i cili ka marrë masa për eliminimin e këtyre defekteve, defektet janë në proces të riparimit.

* Regjistrimi i shenimeve të sjellura nga tereni, gjetja e numrit të referencës (të rekordeve), refreshimi i të dhënave të sjellura nga tereni, kontrollimi i D.B, gjetja e konsëve duke krahasuar D.B me shënimet e inkasantëve si dhe pregaditja e formularit për teren

* Në muajve Janar - Dhjetor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kane arritur qe gjithsej të demontojnë dhe montojnë 1558 ujëmatësa, ekziston raporti i veçant.

* Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Janar - Dhjetor, ka bërë gjithësej 784 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 530 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 27,908 m.

* Leximi i ujëmatësave zonal për muajve Janar - Dhjetor, ujëmatësat në pikat matëse: Sheshi i Lidhjes është ndrruar ujëmatësi (08.02.2017), të ETC-ja është pastruar ujëmatësi (13.02.2017), Vlashnje ujëmatësi fillon vet nga zero, Jusuf Gervalla kemi lexim të ulët arsyja mekanizmi i demtuar (nuk kem mekanizem për ndrrim), Të KFORI, Jusuf Gervalla dhe Mazrek kemi lexim të ulët, Atmaxhë, Nashec i epërm dhe Tupec kemi pusetat me ujë, Landovicë nuk kemi lexim të ujëmatësave, si dhe në Kojush II xhami i thyer (ujematesi i demtuar). Pikat tjera kanë qenë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt.

* Po ashtu në muajve Janar - Dhjetor, kemi pasur 40 rast për riparimin e ujëmatësave që janë sjellë nga vet konsumatorët, ekziston raporti i veçant.

3.1.7 Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: Janar - Dhjetor / 2017

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipin e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit.

Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili \emptyset mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	505	
	3/4"	1027	
	1"	104	
	5/4"	02	
	6/4"	06	
	Gjithsejt:	1644	
Suharekë	1/2"	02	
	3/4"	28	
	5/4"	05	
	Gjithsejt:	35	
Dragash	1/2"	27	
	3/4"	58	
	1"	00	
	Gjithsejt:	85	
Malishevë	1/2"	17	
	3/4"	157	
	1"	02	
	Gjithsejt:	176	

Totali: 1940 copa

Plus:

- Leximi i ujëmatësave 2 herë në muaj.
- 40 Ekspertiza
- Kalibrimi i paisjeve për shqyrtimin e ujëmatësave dhe kalibrimi i manometrave.

3.1.8 Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për Janar – Dhjetor 2017

Aktivitetet

- Kontrolli permanent të klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit, kontrolli i burimeve dhe të stacioneve të klorifikimit si dhe marrja e mostrave.
- Ndalësia të shpeshta të energjisë elektrike-reduktime.
- Riparimi i pompës për klorifikim në O 400 në Mulli.
- Furnizim me kimikate që kanë munguar, në Prishtinë, Era-Med.
- Kontrollimi permanent të klorit rezidual në të gjitha pikat e furnizimit, të burimeve dhe stacioneve të klorifikimit.
- Në stacionin e klorifikimit në Mulli është riparuar pompa për klorifikim në O 400, të cilën po atë ditë kemi riparuar urgjentisht dhe kemi futur në funksion.
- Për shkak të mungesës së energjisë elektrike në objektin për klorifikim në Bunar I, dhe mosfunksionimit të pompave dhe të sondave aparatet për klorifikim janë mbushur me ujë dhe kanë dalë jashtë funksionit. Të gjitha paisjet për klorifikim i kemi demontuar dhe pastruar por, pas montimit kemi konstatuar se nuk mund të bëhet klorifikimi në mënyrë të rregullt. Fal paisjes që kemi pasur rezervë , komplet vacuum rregullator, kemi instaluar dhe kemi aktivizuar sistemin e klorifikimit për tri sisteme të furnizimit, edhe pse sistemi i tillë i lidhjes për klorifikim nuk preferohet. Të cekim edhe këtë se urgjentisht na nevojiten pjesë rezervë për ta mbajtur në mënyrë të rregullt sistemin e klorifikimit. Aparati i montuar është i fundit dhe në rast të ndonjë prishje eventuale sistemi i klorifikimit në tërësi mund të bllokohet.
- Për shkak të shkrirjes së shpejtë të borës ka ardhur deri te rritja e turbiditetit në burime gje që kemi qenë të detyruar në fillim të shkarkojmë komorën mbledhëse në 40Burimet. Por, pasi që procesi i shkrirjes së borës ka vazhduar kemi qenë të detyruar të largojmë (shkarkojmë) tërë sistemin e furnizimit me ramje të lirë dhe në ndërkohë kemi aktivizuar sistemin e pompimit në mënyrë që sado kudo të ketë furnizim me ujë të pijes nga 40 Burimet.
- Vizita në Njësinë Suharekë dhe Malishevë për të diskutuar menyren e marrjes së mostrave në sistemet rurale të furnizimit që menaxhohen nga ana e Hidroregjionit Jugor gjë që ka qenë kërkesë e Bordit të Drejtorave.
- Përgaditja e dokumentit final (disa herë është bërë më parë) për kërkesë të materialit për laborator dhe të pjesëve për klorifikim.
- Dërguam për riparim fotometrin në EraMed Prishtinë si dhe vizituam Ferizajin për të parë mundësinë e sigurimit të pjesëve reserve për klorifikim nga kompania “Toni” dhe për të marrë ofertë për këto pjesë.
- Furnizimi i rregullt me ujë Zhaveli, Kushnin dhe Sërbicë.
- Përcjellja e klorit residual në mënyrë permanente në të gjitha pikat e furnizimit të burimeve dhe stacionet e klorifikimit .
- Pas riparimit të fotometrit Nova 60 kemi shkuar në Era-Med për ta marrë.
- Njoftim zyrtarët të ISHP-Prizren për kontrollin e kualitetit të ujit për punimet që bëhen në ndërrimin e rrjetit te Bunari i gjegjësisht, të kenë kujdes gjatë marrjes së mostrave në mënyrë që të mos ketë ndikim në rritjen e numrit të analizve nëse për çdo eventualitet nuk përgjigjen standardeve të ujit të pijes.
- Vizita në Era-med për t’u furnizuar me material për punë në laborator(pasi që më parë nuk kanë pasur material të nevojshëm që është kërkuar).
- përgaditja e dokumentacionit për tenderim për dezinfikimin e ujit, Klor gaz dhe Hipoklorit Na,
- Furnizim i rregullt me Hipoklorit Natriumi për fshatrat e Hasit, Kushnin dhe Lubizhdë,
- Pranimi i bombolave me klor gaz, 1x 1000kg dhe 5 x 150 kg si dhe 1200 l Hipoklorit Natriumi,
- Marrja e rregullt e mostrave ku janë përfshirë dhe do të përfshihen në të ardhme ujësjellsat rural që menaxhohen nga ana e Hidroregjionit Jugor.
- Kontrollimi permanent të klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit. Burimet dhe sta. e klorif.
- Në Bunarin i ku po zhvillohen punimet në ndërrimin e gypave është çmontuar injektori në Ø400
- Pastrimi dhe dezinfikimi i gypave të rinj të parapra për furnizim te Bunari I.

- Pastrimi dhe dezinfikimi i gypit O 400 si dhe gypat e parapara për shfrytëzim.
- Pas rreshjeve të mëdha është rritur turbiditeti në sistemin e furnizimit në 40 Burime dhe kemi qenë të detyruar të shkarkojmë burimin kryesor dhe si alternative për këtë kemi aktivizuar pompat deri në stabilizimin e gjendjes për furnizim të rregullt.
- Janë riparuar pjesët fazonike të injektorit në O 300, dhe pas riparimit është vazhduar me procesin e klorifikimit.
- Furnizimi i rregullt me hipoklorit natriumi fshatrat, Kushnin Has, Zhur dhe Sërbiçë e poshtme.
- Përcjellja në mënyrë permanente të klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit, përcjellja e punës së klor aparateve në stacionet e klorifikimit dhe gjendjen në burime.
- Marrja e mostrave në Njësitë e HRJ dhe në fshatra.
- Montimi i bombo;ës me Cl-gaz, 1 t.
- Përcjellja disa ditore të gjendjes së furnizimit dhe kualitetit të ujit në Zhur pas ankesave të disa konsumatoreve. Për këtë janë njoftuar ISHP-Prizren dhe Inspektorati Sanitar pranë K.Komunal Prizren. Janë marrë mostrat si nga ana e ISHP-Prizren ashtu edhe nga ana e Laboratorit Hidroregjioni Jugor. Të gjitha analizat rezultojnë të jenë negative gjegjësisht i përgjigjen standardeve të ujit të pijes dhe se problemi i shkaktuar nuk ka të bëjë fare me çështjen e ujit të pijes. Raporti për situatën në Zhur është dorëzuar në tërësi.
- Liferimi i Hipoklorit Natriumi në Zhur, Sërbiçë e Poshtme, Kushnin dhe Lubizhdë të Hasit.
- Pas rreshjeve të mëdha kemi qenë të detyruar të shkarkojmë burimet në 40 Burime, pasi që turbiditeti ka qenë i ngritur. Pasi që burimet u stabilizuan dhe se turbiditeti ka qenë në suaza të normales për furnizim i kemi futur në sistem.
- Riparimi i rregullatorit për klorifikim në objektin Mulliri i vjetër.
- kontrolli i ujit të një lidhjeje të re në Pusin e Atit. Pas pastrimit disa ditore konstatuam se uji mund të përdoret për furnizim, të dedikuar për disa shtëpi. Kërkesë e Njësisë Suharekë.
- furnizimi me reagjent për nevoja të laboratorit në Era-med, Prishtinë.
- Në stacionin e klorifikimit në objektin Mulliri i vjetër është bërë ndërimi i rregullatorit të vjetër me aparat të ri.
- vendosja e injektorit në gypin e ri në Bunari I për nevoja të klorifikimit.
- me kërkesë të menagjerit të Njësisë Suharekë kemi marrë mostra në Savrovë dhe pas analizave kopjet e mostrave i dorëzuam menagjerit.
- Furnizimi i rregullt me Hipoklorit Natriumi, fshatrat, Zhur, Kabash i Hasit dhe Kushnin.
- Dezinfikimi i rezervoarit Gjonaj.
- Vizita te disa konsumatorë që janë ankuar për shkak të kualitetit të ujit.
- Vetura ishte jashtë përdorimit disa ditë.
- Kontrollimi permanent të klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit, kontrolli i burimeve dhe të stacioneve të klorifikimit.
- Riparimi i rregullatorit për klorifikim në objektin „Bunar-1” (rrotometri).
- Vizitë e KFOR-it Gjerman në laborator dhe në objektet e klorifikimit dhe në burime.
- Dezinfektimi i baseneve në Gjonaj (Rez. i ri) e Medvec dhe furnizimi me Hipoklorur të Natriumit si dhe futja në funksion e sistemit të klorifikimit si dhe edukimi i puntorëve që do kujdesen për procesin e klorifikimit.
- Furnizimi me reagjent për nevoja të laboratorit në Era-med, Prishtinë.
- Furnizimi i rregullt me Hipoklorit Natriumi, fshatrat, Zhur, Kabash i Hasit dhe Kushnin.
- Pranimi i ngarkesave me Klor Gas si dhe Hipoklorur të Natriumit.
- Vizita te disa konsumatorë që janë ankuar për shkak të kualitetit të ujit.
- Kontrolli permanent të Cl-rezidual në të gjitha pikat e furnizimit.
- Kontrolli i burimeve dhe tacioneve te klorifikimit.
- Intervenim në Mulli, eliminimi i defektit në rregullatorin për dozimin e klorit.
- Vizita e konsumatorëve që kanë parashtruar ankesë për cilësi të ujit, Rr.Jeta e Re (problem individual) dhe Rr.Leskoveci.

- Montimi i injektorit dhe pjesëve përcjellëse për klorifikim në Bunari I, në O 300. Për shkak të mungesës së pjesëve për klorifikim është bërë kombinimi me pjesë të vjetëruar dhe është në funksion.
- Mbledhe me komisionin këshillues për konsumatorë. Kanë kërkuar informata në lidhje me cilësinë e ujit.
- Aktivizimi i klorifikimit në burimin Gjonaj, dhe edukimi i personelit për përcjelljen e procesit të klorifikimit.
- Marrja e mostrave në të gjitha Njësitë.
- Kontrollimi permanent të klorit residual, të burimeve dhe stacioneve të klorifikimit si dhe marrja e mostrave.
- Eliminimi i ujit në tërësi që ka dëpërtuar në sistemin e klorifikimit në Bunari I. Është bërë pastrimi i të gjitha paisjeve për klorifikim dhe pasi është terur mirë sistemin për klorifikim kemi aktivizuar.
- Rregullimi i dozimit dhe përcaktimit të klorit në O 300 dhe O 400 në Bunari I, 2x.
- Pranimi i sasisë së klorit Gaz dhe Ujë Zhaveli prej operatorit të ri.
- Furnizimi i rregullt të fshatrave, Zhur, Kushnin. Lubizhdë e Hasit dhe Sërbicë, me hipok. Na
- Pranimi i pjesëve reserve për klorifikim nga ana e përfituesit të tenderit për furnizim,
- Eliminimi i defektit në pompën për klorifikim për O 600, te stacioni për klorifikim në Mulli (ndërrimi i kushinetave).
- Kontrolli permanent i klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit, kontrolli i burimeve dhe stacioneve të klorifikimit.
- Pastrimi i kloraparateve në Bunari I, pas dëpërtimit të ujit në kloraparate.
- Aktivizimi i pompave në 3 puse (te livadhi) dhe futja e sasisë së ujit në system për furnizim;
- Pas ankesës së një konsumatori në fshatin Zhur, rast i izoluar, kemi bërë vizitë në shtëpinë e konsumatorit që ka bërë ankesë dhe konstatuam se çdo gjë është në rregull, klori residual ishte 0.2 mg/l dhe se turbiditeti nuk ka. Edhe mostra që kemi marrë rezulton të jetë me standarde të ujit të pijes.
- Furnizimi i rregullt me ujë Zhaveli fshatrat Zhur, Kabash i Hasit dhe Kushnin.
- Vizita në Era-Med Prishtinë për furnizim me reagjent dhe paisje për punë në laborator.
- Vizit te konsumatori që ka bërë ankesë për ujin se i vie era në Rr.Gani Çavdarbasha dhe konstatuam se uji nuk ka as erë as shije dhe as ngjyrë gjegjësisht vetit oraganolepikë të ujit i përgjigjen stadardeve të ujit të pijes.
- Përcjellja permanente e Cl-Rezidual në të gjitha pikat e furnizimit ,kontrolli i burimeve dhe stacioneve të klorifikimit.
- Marrja e rregullt e mostrave në qytet dhe në njësit tjera të KRU" Hidroregjioni Jugor".
- Liferimi i rregullt të ujit të zhavelit për Kushnin, Kabash i Hasit dhe Zhur.
- Me kërkesë të stafit të Njësisë Suharekë vizitë në Pusin e Atit për kontroll të kualitetit të ujit.
- Takim pune në Radoniq- Gjakovë ku është trajtuar tema "Metodat e marrjes së mostrave"
- Pastrimi i rregullatorit të zaptuar në Bunari I.
- Përcjellja në mënyrë permanente të klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit, si dhe kontrolli i ujit të burimeve dhe stacioneve për klorifikim.
- Për shkak të rreshjeve të mëdha dhe turbiditetit të madhë kemi bërë shkarkimin e të gjitha ujërave të burimeve në 40 Burime. Pasi që ka qenë gjendja alarmante i kemi njoftuar mediat të kenë kujdes gjatë konsumit të ujit për oiye. Pas 24 ore burimet fulluan të stabilizohen dhe se sipas turbiditetit/kthjelltësisë një nga një burimet i kemi futur në system duke përcjellur njëkohësisht gjendjen në teren gjegjësisht përcjellja e klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit. Për aktivitetet tona me kohë i kemi informuar edhe Kryeshefin Ekzekutiv. Të Mirren masa të duhura në burimin e parë afër lumit në mënyrë që të mos jetë shkaktarë për ndotjen e burimeve tjera.
- Kemi pasur vizitë zyrtare të delegacionit të KFOR-it Gjerman për shkak të gjendjes alarmante të ujit të pijes për shkak të rritjes së turbiditetit. Gjatë diskutimit i kemi dhënë sqarime te duhura për gjendjen reale të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe shprehën dëshirën që të vizitojnë burimet e furnizimit, gjë që e kemi bërë. Kemi vizituar 40 Burimet si dhe Bunari I dhe II. Kanë qenë të kënaqur

me njoftimin që është dhënë mediave për gjendjen me ujë të pijshëm për shkak të rreshjeve të mëdha. Prezent kanë qenë edhe Drejt. Teknik si dhe Drejt. Financiar.

-Riparimi dhe pastrimi i rregullatorit dhe injektorit në Bunari I.

-Vizita në Prishtinë, në Era-Med, për furnizim me Turbidimetrin e porositur më parë, sipas kontratës gjegjësisht tenderit.

-Fillimi i instalimit të dy pompave (sipas kërkesës) për klorifikim në Bunarin I.

-Për shkak të rreshjeve është bërë shkarkimi i ujit të pijshëm në Zhur. Edhe për këtë njëkohësisht, janë njoftuar mediat dhe se futja e ujit të pijes në sistem është bërë pasi kemi konstatuar se i plotëson kriteret/parametrat e ujit të pijes.

-Sipas ankesës kemi marrë mostra në rr. Petrovë (banesë private) 2 x, ku, pas analizave kemi konstatuar se uji për nevoja të pijes është sipas parametrave të lejuara për ujin e pijes, gjegjësisht rezultojnë të jenë negative. Ankesë zyrtare për këtë çështje nga ana e konsumatorëve nuk është bërë por, kanë bërë analizat sipas tekeve të veta gjë që është demantuar nga ana e ekipit për kontrollë të kualitetit të ujit.

Analizat Bakteriologjike Janar - Dhjetor 2016, ISHP-Prizren

Njësia	Nr.i mostrave	Përgjigjen	Nuk përgjigjen
Prizren	597	592	5
Suharekë	69	64	5
Dragash	26	25	1
Malishevë	60	54	6
Totali	752	735	17

Analizat Bakteriologjike Janar - Dhjetor 2017, ISHP-Prizren

Njësia	Nr.i mostrave	Përgjigjen	Nuk përgjigjen
Prizren	754	754	0
Suharekë	96	96	0
Dragash	40	40	0
Malishevë	95	95	0
Totali	985	985	00

*analizat e ujit të burimeve nuk mirren në konsideratë. Uji i patrajtuar.

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjellësit është 985 nga këto të gjitha i përgjigjen.

3.1.9 Raport për trajtimin e Ujerave të Zeza, Janar – Dhjetor /2017

Faza e parë I e projektit

“Ndertimi i Kolektorit Kryesor”

- **Të dhënat Teknike**

-Gjithsejt gjatësia e kolektorit që do të instalohet është rreth 5100m.

-Diematri i kolektorit fillon nga DN500mm deri në DN1200mm në hymje të ITUZ-se dhe DN 1000mm në dalje të ITUZ-se. Tipi i gypit është HDPE i bronzuar SN8(CL 8kN/m²) dhe Gize K9.

- Kolektori do të vendoset në rrugë në anën e djathtë të rrjedhjes së Lumbardhit dhe do të vendoset në vendin e kolektorit të vjetër, ku do të përfshijë këto rrugë: Enver Haradinaj, Remzi

Ademaj, pjeserisht Wiliam Wolker, Rrugen magjistrale M25 deri tek ITUZ, ndersa vazhdimi i kolektorit nga rrethi i fshatit Hoqe e Qytetit deri tek kyqeja Jugore e Autostrades do te kaloje ne mes te rruges M25 pastaj nga ky pozicion do te vazhdohet deri tek kyqeja ne ITUZ.

-Vlera e punimeve sipas kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A eshte: 2,043,273.00 Euro.

Afati (data) i fillimit te punimeve

-Sipas planit dinamik te pershkruar ne kontrate punimet duhet te fillojne te Henen me 15.12.2014 dhe duhet te perfundojne te Henen me 12.12.2016, mirpo per shkak te vonesave ne rregullimin e pelqimeve dhe lejeve te cilat jane te domosdoshme per fillimin e punimeve kemi pasur ngecje ne fillimin e realizimit te punimeve ne teren.-Perfundimisht pas marrjes se te gjitha pelqimeve dhe Lejes nga Drejtoria per Planifikim dhe Urbanizem punimet kane filluar me date 06.06.2015 pasi qe eshte bere furnizimi me material konform kontrates.

Progresi i punimeve ne Faza e pare I te projektit

Ne Pjesen A (Task A) deri me tani jane realizuar hapja e kanalit, vendosja e zhavorit, vendosja e gypave, mbulimi I kanalit te gjitha keto sipas detaleve te dhena ne projekt dhe ate;

Instalimi i Gypave te kolektorit 1265 m.

-Gypi DN800mm HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m²) L=1215 m,

-Gypi DN1000mm HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m²) L=1300 m,

Instalimi i pusetave nga P101 deri P151 gjithsej 150 puseta, si dhe te gjitha pjeset percjellese.



fig 1. Punet ndertimore Task A, P117 to P12

- Kane perfunduar punimet ne ndertim te pusetes shkarkuese (kaperderdhesit) CSO S1 tek rrethi i fshati Hoqe e Qytetit, ku ky kaperderdhes eshte ndertuar brenda trupit te rruges M25 dhe njeherit bene lidhjen e kolektorit ekzistues me ate te kolektorit te ri.




Fig 2. Punet ndertimore Task A, CSO 1

Obligimet ndaj kontraktorit

Ne baze kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A eshte realizuar edhe pagesa e avansit me vler 20% te kontrates mjete keto te siguruar nga Qeveria e Republikes se Kosoves permes ministris se linjes MMPH.

Sa i perket furnizimit me material nga kontraktori ne si Hidroregjion kemi bere kerkesat e duhura ne MZHE per mundesine e lirimit nga taksat doganore, i kemi derguar ne MZHE te gjitha dokumentet e nevojshme ne lidhje me mundesine e lirimit nga Taksat doganore per pjesen qe do te financohet nga KfW.

Momentalish kane filluar punimet tek CSOS1g te Marashi dhe kolektori te lokacioni i ETC-se. Eshte nenshkruar IPC 1-Fatura e pare per punekryerje te Fazes I nga ana jone dhe eshte derguar tek Passavante, e cila pastaj duhet te dergohet tek KfW pasi qe kjo pagese do te kryhet nga KfW. Kontigjenti i dyte per Fazen I i furnizimit pas kerkeses sone dhe plotesimit te dokumentacionit perkates ne MZHE, eshte liruar nga TVSH-ja.

Ne muajin Prill kan filluar punimet per ndrrimin e gypit ne rrugen Remzi Ademaj ne pjesen prej Komunes deri tek Hotel Theranda, me nje gjatesi preh 475m, deri me tani kemi perfunduar afersisht 60% te ketije segmenti, njekohesisht eshte bere ndrrimi gypit te ujesjellesit.

Eshte instaluar gypi i kanalizimit me je distance prej 30m dhe kycja ne kolektorin e ri.

Punimet jane duke vazhduar ne kete segment dhe shpresojme qe do te perfundojne sipa planit dinamik te paraqitur nga Kontraktori.

Ne fund te muajit Maj kan perfunduar punimet ne pjesen prej komunes deri tek Theranda te kolektorit te ujerave te zeza.

Sipas drejtorit te sherbimeve publike ne komunene Prizrenit, nuk do te jepet leja per zhvillimin e punimeve pr muajin Qershor, Korrik dhe Gusht, arsyeja shte pengesa ne qarkullimin unazor te qytetit si shkak i ngarkesave nga vizitat te cilat i ka qyteti i Prizrenit.

Gjate muajit qershor eshte dhene leja nga DSHP-ja ne Prizren per pjesen te Mulliri ne Tabahane, jane duke u zhvillur punimet sipas planit dinamik te parapare nga kontraktori.

Sa i perket Fazes 1 deri ne fund te vitit 2016 jane perfunduar rreth 90% e punimeve, si pune te cilat kane mbetur per vitin 2017 jane:

Disa pune finale ne Task B perfshire dhe kycjen ne rrjetin egzistues te Kanalizimit tek Gjykata Themelore.

Vazhdimi i Task A, Gypi Paj Pasi dhe Gypi shkarkues nga ITUZ-*ja deri ne Lumbardh

Pjesa nga shkarkimi i pare te 34-shi deri tek Kaperderdhesi ne Ralin,

Faza testuese e sistemit te projektit FAZA 1.

Sa i perket Pagesave te rregullta, pagesave per pune shtese (Varicion order), pagesave per shkak te vonesave (Claim-ave) pagesave per TVSh dhe Dogana, ende jane ne proces dhe PASSAVANTE i ka skaduar garancionet per Pagese te Avancit dhe Garancioni i performances, pa keto garancione valide Passavantit nuk do ti behet asnje pagese e radhes nga KfW-ja.

Si shtojce e pershkrimit te fazes 1 te projektit te ujerave te zeza per muajin Qershor:

Deri me tani kane mbetur pa u realizuar rreth 10% e punimeve, qe nenkutupon si shkak i mos shpronosimit nga ana e komunes e pjeses jashte Impiantit ku do te vendoset gypi shkarkues nga ITUZ deri ne Lumbardh nuk jane kryer punimet nga kontraktori, kontraktori ka bere furnizimin me gypat GRP te cilet do te vendosen ne ate pjese mirpo ende nuk jane vendosur, pjesea e incizimeve me CCTV ende nuk eshte perfunsuar edhe pse Klienta (HRJ) me kohe i ka dorezuar hartat e specifikuara se ku duhet te behet inspektimi me CCTV, si dhe pjesea ne fillimi te kolektorit pra ne afersi te Marashit me nje distance prej rreth 50 m e cila eshte lene qellimisht te realizohet parallel me projektin e ndrrimit te gypit kryesor te ujit nga 40 burimet deri te Rezervoari SHPATI, si dhe kane mbetur disa imtesuara tjera te cilat sipas planit do te determinohen kur te behet inspektimi i kolektorit per pranimin teknik.

Vlene te theksohet se gjate takimeve javore dhe mujora ne mes te Kontraktorit te Fazes 1, Konsulences dhe Klientit (HRJ), eshte konstatuar se kontraktori nuk eshte duke realizuar punimet konform planit dinamik dhe i njejti pa kurrfar arsye kerkon mjete shtese te cilat ne si kompani kemi te drejte te mos i pranojme. Per me gjeresisht munde te informoheni permes minutave te takimeve, raportit periodik dhe raportit tremujor te cilin e perpilon Konsulenca e Projektit P2m dhe njoftohen KfW dhe te gjitha palet tjera te involvuara ne kete projekt.

Ne muajin Tetor nuk ka ndonje ndryshim per Fazen 1 te projektit te Ujerave te Zeza.

Momentalish eshte rregulluar dokumentacioni per situacionin e fundit te punimeve dhe eshte derguar tek KfW per pagese. Sa i perket dokumentacionit te pergjithshem per pranim teknik dhe dorezimin e projektit tek ne, eshte duke u rregulluar dokumentacioni.

Faza e pare I e projektit

Ndertimi i Kolektorit Kryesor

“ Per ecurine e aktiviteteve dhe progresit te punimeve per Fazen 1 “Ndertimi kolektorit kryesor” jeni njoftuar permes Raporteve mujore gjate vitit 2016 dhe 2017, me qe kjo Faze ka perfunduar ne raportin e muajit te fundit te vitit 2017 po ju njoftojme me obligimet e ndersjellta ne mes te KRU”HRJ”-se dhe Kontraktorit PASSAVANTE & KWE ne lidhje me

Fazen 1 te projektit:

Projekti ka perfunduar conform kontrates,

Periudha e komisionimit eshte 12 muaj pas perfundimit te projektit dhe nenkupton qe brenda kesaje periudhe munde te kete defekte eventuale ne project, me crast kontraktori eshte i obliguar qe brenda kesaje periudhe ti sanoje te gjitha defektet ose problemet ne kete projekt ne te kunderten nuk do ti paguhet pagesea e cila i eshte mbajtur ne cdo situacion te pagesave me nje perqindje prej 5% te vleres.

Pagesa per fazen 1 te ketije projekti eshte kryer plotesisht ne perjashtim te nje pjese e cila eshte mbajtur per gjate implemtimit te projektit, kjo pagese qe kap vleren rreth 115,000.00 euro do te paguhet pasi qe te perfundoj afati i komisionimit i cili sipas kontrates eshte 12 muaj, kjo pagese do te realizohet tek kontraktori ne momentin kur do te perfundoj periudha e komisionimit diku kah muaji shtator 2018.

Per te dhena tjera ne lidhje me fazen 1 te projektit kemi ne dispozicion Raportin Periodik te perpiluar nga Konsulenca P2m dhe Alb Architect, si dhe nga kryetari i komitetit te ketije projekti Lulzim Paçarizi ”.

Faza e dyte II e projektit:

“Dizajnimi dhe ndertimi i Impiantit per trajtimin e ujerave te zeza”

- Projekti ka të bëjë me dizajnimin dhe ndërtimin e ITUZ-së, per realizimin e ketij projekti me date: 05.05.2015 eshte nenshkruar kontrata ne mes te kompanise AQUALIA nga Spanja si dhe KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh.A, vlera e kontrates eshte 10,354,512.41 EUR .

Sipas marrevshjes kontraktuale per kete porjket duhet te paguhet avanci me vlere prej 20% e vleres se kontrates, pagese te cilen duhet ta paguaj MMPH.

-Deri me tani konform marrevshjes speciale te reviduar nga ana e kontributit vendor jane paguar ne emer te avancit per Fazen II, 625,000.00 Euro kurse pjesa e mbetur duhet paguar nga KfW.

Bazuar ne Marrevshjen e vecant ne te cilen eshte qartuesuar planifikimi i mjeteve per kontributin vendor dhe kontributin e jashtem, eshte riplanifikuar buxheti i kontributit vendor ku dhe sipas minutave te takimit te dates 14 Tetor 2015 te nenshkruar nga MMPH, Komuna e Prizrenit, HRJ dhe KfW eshte parapare:

Kontributi vendor i ndryshuar pas marrveshjes se reviduar me date 07.04.2017 i nenshkruar nga KfW, Komuna e Prizrenit dhe MMPH ka ndare kete buxhet:

2014	Euro	FAZA I	99,763.70
2015	Euro	Pjesa e pare e vitit FAZA I	374,275.82
2015	Euro	Pjesa e dyte e vitit FAZA II	625,000.00
2016	Euro		199,168.12
2017	Euro		2,400,000.00
2018	Euro		1,301,792.36
			=====
			5,000,000.00 EURO

Vlene te ceket se mjetet e shpenzuara nga MMPH per projektin e Fazes 2 gjate vitit 2017 deri me tani jane gjithsejt 202,377.80, mbetet qe deri ne funde te vitit 2017 te rriten aktivitetet e punes nga kontraktori ne menyre qe te munde te shfrytezohet komplet buxheti i vitit 2017.

Aktivitetet e ndërtimit Faza 2

Kontraktori ka finalizuar çështjet e mobilizimit dhe ato administrative. Faturat e pagesës së avansit eshte dorëzuar.

Tani kontraktori është duke punuar në projekt,

- përditësimi i trasesë (layout) së Impjantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në bazë të kërkesave të punëdhënësit,
- përgatitja e orarit të projektimit dhe planit dinamik është në progress,
- kordinimi për zhvendosjen e linjës së rrymës elektrike mbitokësore me KEDS-in,
- kordinimi i pikave kyqëse të furnizimit me rrymë për Impjantin për Trajtimin e Ujërave të Zeza me KEDS-in,
- kontraktori do të angazhojë një kompani për të bërë matjet gjeodezike.

Periudha e projektimit është 120 ditë. Për të shmangur vonesat për shkak të dokumenteve jo të kënaqshme të projektit, është pajtuar që të dorëzohen projektet në pako.

Pakoja e parë – Projekti Konceptual i Azhurnuar u dorëzua me 24 Korrik

- Që përbëhet nga një vizatim i trasesë (layout), P&ID, profil hidraulik.

Pakoja e dytë – Projekti Kryesor pritët me datën 30 Shtator

- Vizatimet që kërkohen për marrjen e lejes për projektet e kategorisë III, p.sh. projektet civile për të gjitha strukturat dhe njësitë, të gjitha vizatimet layout (të përgjithshme, gypat, rryma, rrugët, hapësira, etj), vizatimet e azhurnuara të projektit konceptual. Ku kjo pako është prezantuar në takimi e fundit të mbajtur në HRJ në fillim të muajit Nentor 2015

Pakoja e tretë – Projekti i Detajuar pritët të jetë pjesërisht krahas me progresin në ndërtim.

- Vizatimet detale që kërkohen për ndërtimin e secilës njësi/ndërtesë/strukturë, duke përfshirë kalkulimet statilke, lista e paisjeve etj. (krahas progresit të projektit).

-Në takimin e fundit gjatë muajit tetor kemi patur një takim me kontraktorin e Fazës II dhe Konsulencën ku dhe kemi diskutuar në lidhje me shtrirejen-situacionin e brendshëm të impiantit, që nënkutpon metodën e trajtimit, shtrirejen e objekteve administrative dhe percjellese, dhe pritët miratimi nga ana e HRJ-se.

-Punëdhënësi HRJ ka shprehur gadishmërinë për t'i asistuar Kontraktorit në të gjitha çështjet për të marrë lejet e kërkuara. Ligjet relevante dhe udhëzimet administrative iu janë dhënë Kontraktorit.



Pamja e ITUZ-se në 3D

-Për shkak të pengesave nga pronarët e shpronësuar nuk ka aktivitete të ndërtimit deri më tani

-Në bashkë me konsulencën dhe kontraktorin në një takim në zyrën e DSHP-se dhe përmes një shkrimesh elektronike e kemi njoftuar DSHP në komunën e Prizrenit, për pengesat që i kemi nga pronarët e shpronësuar të lokacionit ku do të ndërtohet ITUZ dhe kemi kërkuar nga DSHP si bartese e projektit për shpronësim që të ndërmarre masat e duhura që mos të ngëcim me projektin në fjalë pasi që çdo vonesë do të reflektoje në kosoton e projektit si dhe do të rrezikoj investimin në përgjithësi.

-Pas bissdes telefonike qe kam pas me zyrtarin komunal ne zyren e pronave ne komunen e Prizrenit, z. Gursel Skenderi, me eshte thene se pa u paguar edhe centi i fundit tek pronaret ne nuk kemi te drejte qe pronat e tyre ti bartim tek Komuna.

-Sa i perket lejes se ndertimit te cilen duhat ta kerkojme tek Departamenti i ndertimit ne MMPH, paraprakisht duhet nxjerre dokumenti i VNM-se , i cili po ashtu kerkon kriterin kryesor shpronasimin perfundimyatre te lokacionit, prandaj ne rast se kemi pengesa ne pagesen e pronarve, komuna e prizrenit duhet te krijojte nje KONTO MIREBESIMI ne te cilen duhet te derdhe te gjitha mjetet e parapare per shpronasim dhe ne momentin qe do ta kemi kete dokkument do te fillohet me perpilimin e VNM-se si kusht kryesor per posedimin e lejes se ndertimit nga MMPH.

Perpos takimeve per mbarevajtje te punimeve nuk kemi patur ndonje progres te theksuar ne lidhje me Projektin ne fjale,

Pas takimit me Drejtorin e sherbimeve publike ne nje konference i njejti gojarisht me tha qe sa i perket kontos se mirebesimit ajo do te nxjerret nga komuna vitin e ardhshem ne fillim te 2016.

Pronat e shpronasuara tani me jane bartur ne emer te Komunes se Prizrenit dhe pritet qe shume shpejt ky lokacion te na jepet ne shfrytezim ne si KRU"HRJ" me crast dhe do te kemi mundesi qe ti plotesojme kushtet per leje te ndertimit ne MMPH.

Per shkak te ketyre vonesave ne kemi hyre ne obligime shtese ndaj kontraktorit AQUALIA afersisht 170,000.00 euro.

Ne me kohe i kemi bere kerkesat per paisje me te gjitha dokumentacionin i cili duhet te pergaditet nga organet komunale dhe qendrore per Fazen 2 te ketije projekti.

Pas takimit javor qe kemi pas me kontraktorin e Fazes 2 dhe Konsulencen e kemi perpiluar nje plan se kur munde te merret leja e ndertimit nga MMPH dhe kur munde te kemi casje legale ne vendin ku do te ndertohet ITUZ.

Sipas ecurive te procedurave ne kemi parapare qe me se largu deri me daten 15 Korrik 2016, kontraktori munde te filloje me mobilizimin dhe rrethomin e lokacionit ku do te ndertohet ITUZ.

Per ecurine e komplet projektit kemi ne dispozicion Raportin Periodik te cilin e perpilon Konsulenca dhe e dergon tek KRU"HRJ dhe KfW.

Pas dorezimit te gjitha dokumentacionot per kushtet ndertimore per ITUZ-ne, MMPH ka konkluduar se fillimisht do te leshohen Kushtet ndertimore vetem per te filluar me mobilizimin e puneve te cilat do te behen ne lokacionin e ITUZ-se, koha kur do te leshohen kushtet ndertimore eshte me 16 Shtator, 2016, pas kesaje do te aplikohet per leje ndertimore e cila nenlupton fillimin e ndertimit te ITIZ-se.

Kemi korespondenca te rregulltga me KfW dhe Konsulencen ne lidhje me Pagesat, taksat, pelqimet etj.

Per te dy fazat kemi Raportet Periodike te pergaditura nga Konsulenca.

Per shkak te Lejes se ndertimit ende nuk kemi mundesi te fillojme punimet ne Fazen 2 te Projektit.

Edhe ne muajin Tetor nuk ka ndonje levizje ne aspektin e fillimit te punimeve ne Fazen 2 te projektit te ujerave te zeza, per mkmentin ende nuk kemi ndonje levoizje nga Komuna e Prizrenit per 11 parcelat qe menaxhohen nga AKP-ja, te cilat duhet te barten ne emer te Komunes se Prizrenit.

Sa i perket fillimit te punimeve per Fazen 2, Kontraktori me daten 20.12.2016, ka filluar me punet pergaditore.

Sa i perket pagesave per vonesa ndaj AQUALIA-s, ne kemi pranuar pagesat prej 01 deri ne 08, dhe prej 09 deri 11 me te gjitha miratimet e duhura, me keto kerkesa eshte njoftuar edhe DSHP-Komuna e Prizrenit e cila dhe ka ndare sipas marreveshjes 600,000.00 Euro te cilat tani me jane transferur ne llogarine e KRU"Hidroregjioni Jugor".

Per me gjeresisht posedojme raportin Periodik nga Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi.

Perpos pershkrimin te projektit nga muajt paraprak, po raportojme Si shtojce e pershkrimin te fazes 2 te projektit te ujerave te zeza per muajin Qershor:

Edhe perkunder nje marrveshje interne (gjentelmene) ne mes te kontraktorit, Konsulences dhe HRJ-se dhe perfaqesuesve te MMPH-se (*ekzistojne minutat e takimit*) qe projekti te filloje me 20 dhjetor te vitit 2016 ku per shkak te mungeses se lejes se ndertimit, jemi marr vesh qe permes shkresave te kryhen vetem punet pergaditore qe nenkupton rrafshimin e terenit, hapjen e rrugeve, ndertimin e

zyreve te perkoheshme, sigurimine perkoheshem te furnizimit me uje, sigurimin e perkoheshem te furnizimit me energji elektrike etj, ne nga kjo marrevshje jemi dakorduar qe punimet te fillojne dhe te mos kemi fare ndalesa pra te fillojne punimet edhe me germimet tjera me vendosjen e veprave te betonit ku do te instalohen paisje dhe pajime sipas projektit, mirpo kontaktori i fazes 2 , ka hezuar ta beje nje gje te tille duke u thirrur ne mungesen e lejes se ndertimit, gje qe nuk do te pranohet nga ana jone. Kontraktori ka perfunsuar rreth 90% te puneve pergaditore te cilat dhe i jane paguar permes IPC1 dhe IPC 2, mirpo ka qene dashte te vazhdoje me punimet tjera e jo te thirret ne mungesen e lejes se ndertimit.

Sa i perket fillimit te impementimit te projektit te faza e trajtimit primar qe nenkupton vendosjen e paisjeve te trajtimit fizik, kontraktori pretendon se ka pengesa nga Instituti arkeologjik i Kosoves i cili edhe pse ka leshuar pelqimin per vazhdimin e procedurave per nxjerrjen e lejes se ndertimit i njeiti ne pelqim ka cekur se ne rast te nevojtes per survejim te karakterit te shpetimit ata munde te fillojne germimet ne lokacion, te njejtit kane filluar germimet, mirpo ne munges te fondeve te duhura sipas tyre nuk kane mundesi te shpejtojne punimet.

Kontraktori arsyetohet se jane duke e penguar keto germime, mirpo sipas nesh nuk qendron kjo gje pasi qe kontraktori ende nuk ka perfunduar projektin detal perfundimtar i cili duhet te shqyrtohet te vuloset dhe te nenshkruset nga palet, e pastaj te filloje me implementimin e projektit.

Duhet cekur se kushtet ndertimore jane dhene nga MMPH dhe ne si klient garantojme se me se largu deri ne gjysmen e muajit qershor do te leshohet edhe leja ndertimore nga MMPH.

Sipas dokumentacionit te kontartes kontrata me AQUALIA & Hidroterm skadon ne fund te muajit MAJ, nga kosnulenca kemi kerkuar qe te inicohen procedurat e nevojshme per vazhdimin e kontrates per Fazen 2.

Ne muajin Qershor eshte marre Leja e ndertimit nga MMPH, me te cilen konstatohet se munde te fillojne punimet brenda afatit prej 9 diteve ne Fazen 2 te projektit,

Kemi disa pengesa te vogla ne lokacionin e ITUZ-se pasi qe grupet arkeologjike jane duke vazhduar punimet per ruajtjen e mbetjeve te mundshme arkeologjike.

Per me gjerisht ekzistojne raportet periodike dhe tremujore te perpiluara nga konsulenca e projektit P2m Berlin, ku njoftohen KfW dhe te gjitha palet tjera te projektit.

Sa i perket progresit te punimeve ne Fazen 2 gjate muajit Korrik, kontraktori eshte duke zhvilluar punimet konform planit dinamik te pershkruar ne kontrfate, kemi patur disa pengesa te vogla nga Instituti Arkeologjik i Kosoves i cili eshte duke zhvilluar germime me karakter shpetimi te mbetjeve te mundshme arkeologjike, ne si kompani kemi njoftuar te gjitha instatncat relevante per mundesine e mbulimit te koston se ketyre germimeve, mirpo deri me tani nuk na eshte pergjigjur askush, kemi njoftuar edhe banken Gjermane KfW dhe kemi kerkuar nga ta qe permes fondit te rimbursuar nga Komuna e Prizrenit te behet i mundur mbulimi i kesaje kostoje, te njejtit jo formalisht na kan thene se projekti nuk ka fonde per mbulimin e kesaje kostoje.

Punimet jane duke u zhvilluar dhe ne te ardhmen munde te kemi pengesa ligjore nga Instituti Arkeologjik i Kosoves, mirpo pengesa tenike nuk kemi por per arsye te pageses se koston kemi marr disa njoftime nga IAK te cilat munde te na paraqesin probleme administrative.

Ne muajin Tetor sipas je marrevshje te nenshkruar ne mes te Institutit Arkeologjik dhe KRU"HRJ" eshte bere kesti I pare I pageses se puneve arkeologjike ne vlere prej 25,000.00 Euro nga buxheti vetanak I kompanise.

Gjendja e pagesave nga MMPH tek Kontraktoret per Fazen 2 te projektit te ITUZ-se.

- Sipas Marrevshjes se vecant (LEa4) te nenshkruar se fundmi me date 13.04.2017, nga KfW, MMPH, KRU"HRJ" dhe Komuna e Prizrenit, per vitin 2017 nga Buxheti i MMPH-se jane parapare 2,400,000.00 Euro per Projektin e Ujerve te Zeza ne Prizren/Faza 2 Impianti per Trajtimin e Ujerve te Zeza ne Prizren.

- Nga kjo vlere per vitin 2017 qe nenkupton deri me sot jane shpenzuar-paguar nga MMPH gjithsejt 1,032,697.98 Euro.

- Sipas Planit Dinamik te punimeve nga kontraktori AQUALIA ne muajin Nentor dhe Dhjetor te vitit 2017 do te shpenzohen edhe 197,850.00+246,951.00=444,801.00 Euro.

- **Buxheti i parapare nga MMPH per vitin 2017:** **2,400,000.00 Euro**
- **Te shpenzuara per vitin 2017: 1,032,697.98+444,801.00 = 1,477,498.98 Euro**
- **Mbeten pa u shpenzuar per vitin 2017 edhe:** **922,501.02 Euro**

Verejtje:

Me qe sipas Planit Dinamik te punimeve te pershkruar ne marreveshjen Kontraktuale ne mes te KRU"HRJ" dhe Kontraktorit AQUALIA per Fazen 2 te Punimeve "Dizajni dhe Ndertimi i Impiantit per Trajtimin e Ujerave te Zeza ne Prizren" eshte parapare qe punimet te perfundojne ne fund te vitit 2018, MMPH konform Marreveshjes Financiare eshte e obliguar qe per vitin 2018 te ndaj mjetet e nevojshme, te mbetura per kete projekt:

Te zotuar nga MMPH sipas Marreveshjes:	5,000.000.00 Euro
Te shpenzuara deri me tani ne projekt:	<u>2,775,706.62 Euro</u>
Nga MMPH mbetet te ndahen per vitin 2018:	2,224,293.38 Euro

Qe nga fillimi I muajit Tetor ne lokacionin ku eshte duke u ndertuar ITUZ, nuk kemi kurrfar pengese ne aspektin administativ, me cka munde te konstatojme se Progresim I punimeve eshte duke rrjedhur normalisht, conform planit dinamik te rishikuar.

Ne dispozicion eshte Raporti periodik nr.48 per muajin nentor, raport te cilin e formulon Konsulenca P2m.

Per muajin e fundit te vitit 2017, ju njoftojme se Projekti eshte duke u zhvilluar konform kontrates dhe planit dinamik si ne kontraten e cila tani me ka skaduar, mirpo jemi ne pritje te vazhdimet te kontrates konform rregullave te FIDIC dhe miratimit nga KfW.

Data e fillimit te projektit eshte vendosur muaji qershor i vitit 2017 dhe projekti pritet te perfundoj ne fund te vitit 2018, kurse ITUZ paraprakisht nen mbikqyrjen e kontraktorit dhe konsulences munde te filloje operimin me se largu deri ne muaji Shkurt 2019.

Ju lutemi qe ne cfardo kohe dhe pa kurrfar hezitimi munde te kerkoni sqarime shtese ne lidhje me kete projekt nga Kryetari i Komitetit te ketije projekti Lulzim Paçarizi si dhe nga Raportet Periodike qe perpilohen nga konsulenca P2m& Alb Architect.

Masat Shoqeruese (Asistenca Teknike):

Ky projekt eskuzivisht eshte i finnacuuar nga Qeveria Gjermane si grant i paster dhe si qellim kryesor ka mbeshtetjen e projektit te Ujerave te zeza per fazen 1 dhe Fazen 2.

Kontraktori i perzgjedhur per implmentimin e ketije projekti eshte kompoania Gjermane DORSCH nga Gjermania dhe ajo vendore KIWER nga Prishtina,

Vlera fillestare e ketije projekti eshte 721,000.00 euro e percjellur me opsionet 3 dhe 4 te cilat munde ta rrisin vleren e ketije projekti.

Projekti ka filluar me date 07.03.2017 dhe ndahet ne dy faza te Impmenetimit:

- Faza 1 Ndertimi Institucional (24 muaj)
- Faza 2 Mbeshtetje per Operimet e FTUZ (18 muaj)

Detyrat Speciale te Fazes 1

- Hartimi i Strategjise se Tarifave
- Pergatitja e Konceptit te Menagjimit te Llumit
- Detyrat Shtese (opcionale)
- Te percaktohet gjate fazes nismetare

Mbeshtetja per Operimet e FTUZ-Faza 2

- Mbeshtje e stafit gjate leshimit ne funksion te ITUZ-se
- Organizmi i nje vizite studimore (opcionale)
- Detyrat Shtese (opcionale)
- Te percaktohet gjate fazes nismetare,

Mbi bazen e kesaje qe u tha me larte, konsulenca e ketije projekti ka perpluar nje raport fillestar mbi gjendjen egzistuese te kompanise ne te gjitha resoret dhe ka parapare nevojten se ku do te kete

nevoje me shume te intervenohet me trajnime dhe investime, si dhe ka parapare qe te aprovohen opsionet shtese, ky document si draft eshte derguar ne kfW, mirpo KfW ka kerkuar sqarime shtese, te cilat sqarime jane duke u shqyrtuar nga kontraktori ne koordinim me klientin (HRJ) dhe pasi qe raporti fillestar te kompletohet si Raport Final do te kerkohet miratimin nga KfW.

Ne kuader te ketije projekti gjate muajit korrik jane organizuar disa Workshope ne GIS dhe ne Financa si dhe eshte pergaditur kostoja e mundshme te cilen munde ta kete ITUZ gjate operimit, keto te dhena jane derguar ne ARRU permes Plan Biznesit Rregullator dhe do te inkorporohen ne tarifa sidomos gjate vitit 2019 dhe 2020 ateher kur do te filloj te operoj ITUZ-ja

Gjate muajit shtator punimet kan vazhduar conform planin dinamik, per momentin punimet arkeologjike kan ngecur per shkak te se ende nuk eshte kryer pagesa sipas kerkeses se IAK.

Per cdo gje tjeter ne lidhje me kete projekt munde te na kontaktoni ne cdo kohe.

3.1.10 Raporti i Njesive Punuese

Aktivitetet mujore Janar-Dhjetor, 2017 – Njesia Prizren

**Furnizimi me ujë:* ka qenë i rregullt në përgjithsi, përveq në disa zona ku ka reduktime dhe atë: në zonat e larta te qytetit në te cilat kemi reduktime të planifikuara.

**Operacionët e mirëmbajtjes së ujësjellsit dhe kanalizimit:*

Aktivitetet mujore janë paraqit në menyre tabelare.

Gjatë muajve Janar-Dhjetor: janë shqyrtuar gjithesejt **2688** ankesa dhe të gjitha kanë përfunduar me eliminimin e defekteve në ujësjellës dhe kanalizim.

Në rrjetin e ujësjellsit janë bërë **1986** aktivitete, ndërsa në rrjetin e kanalizimit **702** raste.

Gjithsej aktivitete në ujësjellës Janar-Dhjetor			
1	Defektet ne rrjetin sekundar	1802	defekte
2	Defektet ne rrjetin primar	369	defekte
3	Defekte ne komplet rrjetin	2171	defekte
4	Bartja e ujit me cistern	600	m ³
5	Pastrimi dhe fryerja me kompresor	77	raste
6	Rregullimi i rruges	209	m ²

Gjithsej aktivitete në kanalizim Janar-Dhjetor			
1	Kontroll i pusetes	1860	copë
2	Pastrim i pusetes	1018	copë
3	Kontroll i kanalizimi	36857	metra
4	Pastrim i kanalizimi	25098	metra
5	Ndërrim i pusetes	66	copë
6	Ndërrim i kanalizimi	138	metra
7	Riparim i rrugës	201	m ²

Trajtimi dhe klorifikimi:

Këto veprime bëhen pa ndërprerje dhe analizat e ujit nga Enti Higjenik Regjional janë në bazë të raporteve mujore.

Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit

- Përcjellja përmanente e procesit të klorifikimit në qytet dhe regjion (fshatra dhe sipas nevojës edhe në njësit tjera si Suharekë, Malishevë e Dragash).
- Marja e mostrave në qytet, njësi (si „Hidroregjion Jugor”) dhe në Fshatra të cilat menagjohen nga ana jonë dhe punimi i tyre në laboartorin tonë.
Mostrat janë marrur si vijonë:
- Marrja e mostrave Fiziko-Kimike

- Marrja e mostrave Bakteriologjike

Aktivitetet mujore Janar-Dhjetor, 2017 - Njesia Suharekë

* *Furnizimi me ujë, Janar-Dhjetor* - ka qenë i rregullt 24 orë/ditë, përveq 2 ditë kur nuk kem pasur furnizim për arsye të ndërprerjes së energjisë elektrike te stacioni i pompave në malsi të re.

Kemi pasur probleme të vogla me furnizim në fshatrat: Doberdelan, Samadraxhë, Savrovë dhe Studenqan. Mirpo është përmirësuar furnizimi në këto fshatra për arsye të ardhjes së ujërave nëntokësore.

* *Analizat e ujit, gjatë muajve Janar - Dhjetor - 2017* - janë bërë 96 mostra të ujit të pijes nga Institutit i Shëndetit Publik, 96 prej të cilave i përgjigjen standardeve (ISHP).

* *Rregullimi i defekteve - Janar - Dhjetor - 2017* - janë rregulluar gjithsejtë 437 defekte, 354 defekte në rrjetin e ujësjellësit (rrjetin sekondar), 02 defekte në rrjetin kryesorë të azbesti ACC 450mm në Shirok dhe 92 debllokime të kanalizimeve si dhe janë rregulluar 361m² kubëza në ato lokacione ku më herët është intervenuar për rregullimin e defekteve në ujësjellës apo kanalizim.

**Aktivitetet tjera Janar - Dhjetor - 2017*

-*Investime në Shirokë - Zgjerim i rrjetit të Ujësjellësit.*

-*Vendosjes së Ujëmatësve të amvisërisë në Mushtisht.*

-*Vendosjes së ujëmatësve të amvisërisë në Reshtan.*

-*Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Doberdelan.*

-*Shpimi i pusit ne fshatin Doberdelan.*

-*Testimi i pusit në AgroZonë në Samadraxhë.*

-*Vendosja e rezervarit montazh 15m³ ne stacionin e pompave Doberdelan.*

-*Hapja e Kanalit me gjatësi L=150m në Mushtisht.*

-*Pastrimi i rrethojave dhe sigurimi i zonës së parë mbrojtëse*

Janë pastruar dhe rregulluar zonat e para mbrojtëse të hapësirave të stacioneve të pompimit në: Studenqan, Reshtan, Doberdelan, Samadraxhë, Savrovë, Topallnica dhe rezervuarëve: Shirokë ,Savrov, Mushtisht,Doberdelan,Samadraxhë,Studenqan.

-*Rritja e sasisë se ujit (Vendosja e pompave)*

Janë nxjerr nga puset pompat 2 herë Doberdelan dhe 1 herë në Samadraxhë, 2 pompat Nr.1 dhe Nr.3 në S.P- Samadraxhë janë zbritur në puse për 15m' për arsye të uljes së nivelit të ujit nëntokësor është bërë kycja e dy puseve Nr.1 dhe Nr.2 ne gypin Ø450mm te Pusi Atit, janë riparuar pompat ne këto lokacione: (Pusi Nr.1 SP-Pusi, Pusi Nr.2 SP-Fidanishte, Pusi Nr.2 dhe Nr.3 SP- Krisma) rritja e sasisë së ujit për qytet, (Pusi Nr.2 dhe Nr.3 S.P- Samadraxhë) rritja e sasisë së ujit për fshatin Samadraxhë si dhe janë pastruar rezervuarët ne fshatrat: Savrovë dhe Doberdelan.

Aktivitetet mujore Janar-Dhjetor, 2017 – Njesia Malishevë

**Furnizimi me ujë gjatë muajve, Janar - Dhjetor - 2017* – ka qenë i mirë në zonat e shërbimit, kemi pasur një numër mjaft të madh defekteve në të dy rrjetet si dhe defekte mjaft të shpeshta dhe ndërprerje të rrymës të pompave si: në Banje dhe në Gurbardh.

Probleme me furnizim të plot kemi pasur gjatë muajve të verës në fshatrat: Carralluke, Drenoc, Lladroc, Bellanicë, Dragobil, Maxharr dhe Turjak.

**Analizat e ujit, Janar - Dhjetor - 2017* - janë realizuar 95 mostra të analizave bakteriologjike dhe 95 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

**Aktivitetet lobimi* - kontakte të rregullta me perfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, atë të Urbanizmit si dhe me Drejtorin e Financave.

**Rregullimi i defekteve, Janar - Dhjetor - 2017*- rrjeti primar 249 defekte, rrjeti sekondar 241 defekte, debllokimi i kanalizimeve 97 ndërhyrje dhe 13.65 km kanal të pastruar, ujëmatësa të ndërruar 154,

ujëmatësa të montuar 92, ankesat teknike 62, ankesat komerciale 131, kyqje të reja 459, amvisëri 446, lokale 7, institucione 7, njoftime për shkyqje 257, procesverbale për pagesë 228, verifikim të ujëmatësve 1702, ri programim te borxhit kontrata 117, bllobim te ujëmatësve 1026.

Aktivitetet mujore Janar-Dhjetor, 2017 - Njesia Dragash

*Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë munduar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këti muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftushëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh. Është pastruar edhe kaugullatori.

*Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

*Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto: 77 raste sanim në rrjetin e ujësjellësit, 104 ndrrime të ujëmatsave, 142 pastrim dhe kontrole të ujëmatsave, 24 montim i ujëmatesit te ri, 23 kyqje në rrjetin e ujësjellësit, 63 sanime në rrjetin e kanalizimit, 537 m.debllokime dhe pastrime në rrjetin e kanalizimit, 118 angazhime tjera të ekipit teknik.

*Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon kompania duke i përfshire punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratë së përgjithëshme.

*Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimit në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.

*Prodhimi i ujit, Janar - Dhjetor - janë prodhuar 963,848.00 m³ ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

*Humbjet e ujit, Janar - Dhjetor - arrijnë rreth 84.80 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.

3.2. AKTIVITETET NGA SHËRBIMI RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.2.1 Aktivitetet kryesore

- Është bërë leximi i ujëmatësve nga Inkasantët (lexuesit) e terrenit .
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit .
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve

Janë vizituar nga ekipet e kontrollës konsumatorët për mospagesë të shërbimeve të ujësjellsit, të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të mëdha ndaj KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha. Secilit konsumatorë të vizituar nga ekipet e kontrolles i është lënë procesverbali ku ceket borxhi dhe afati për pagesën e borxhit.

- Janë bërë kontrolle në teren te konsumatorët nga ekipet e kontrollës edhe për shqyrtim të ankesave të konsumatorëve dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.
- Janë kontaktuar konsumatorët institucional të cilët kanë borxhe e të cilët në përfundim të buxhetit kanë mundësi buxhetore ti paguajn faturat e akumuluar.

3.2.2 RAPORTIMI EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES

2016

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve
1	Prizren	955	4	5	38.831
2	Suharekë	144	40	27	16.585
3	Malishevë	461	61	22	12.789
4	Dragash	5	0	0	0
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	1.562	105	54	68.204


JANAR- DHJETOR - 2017

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Proceverbale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga kontrolla
Prizren	1,217	79	73	6,369	5,998	23,829.16
Suharekë	188	63	45	2,632	5,247	9,725.55
Malishevë	193	11	8	593	1,423	0
Dragash	3	-	-	-	10	0
KRU. HJ	1,601	153	126	9,594	12,678	33,554.71

3.2.3 RAPORTI I ANKESAVE


2016

MUAJI	JAN	SHKU	MAR	PRILL	MAJ	QER	KORR	GUSH	SHTA	TET	NEN	DHJET	TOTAL
ANK. TEK.	84	121	101	116	122	122	132	143	125	135	144	139	1.484
ANK. KOM.	40	53	69	45	89	70	84	95	75	62	77	73	832
TOTAL	124	174	170	161	211	192	216	238	200	187	221	212	2.316



JANAR- DHJETOR - 2017

MUAJI	JAN	SHKU	MAR	PRILL	MAJ	QER	KORR	GUSH	SHTA	TET	NEN	DHJET	TOTAL
ANK. TEK.	139	158	170	135	157	167	181	177	149	204	182	136	1.955
ANK. KOM.	91	149	93	76	78	76	92	112	69	88	75	93	1.092
TOTAL	230	307	263	211	235	243	273	289	218	292	257	229	3.047



Koment:

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar me kohë. Konsumatorët kanë marrë përgjigje zyrtare nga kompania.

Një numër i konsideruar i ankesave është konstatuar se kanë qenë të babazuara.

Raport i faljeve të borxheve- Janar-Dhjetor 2016

Njesia	NrKonsumatoreve	NrKontratave	ShumaKontraktuar	ShumaInkasuar	ShumaFalur
DRAGASH	127	133	25,100.76	11,771.95	39,730.29
MALISHEV	133	141	43,884.91	3,528.41	14,541.00
PRIZREN	4289	4404	917,614.03	215,585.53	1,163,385.33
SUHAREK	618	685	166,700.47	23,616.54	52,255.62
Total	5,167	5,363	1,153,300.17	254,502.43	1,269,912.24

2.2.4 Raport i faljes së borxheve Janar- Tetor 2017

Njesia	NrKonsumatoreve	NrKontratave	ShumaKontraktuar	ShumaInkasuar	ShumaFalur
DRAGASH	345	85	33,381.37	6,374.40	23,565.48
MALISHEV	111	116	35,443.18	1,748.84	10,808.51
PRIZREN	9313	3089	1,137,242.36	176,681.14	865,038.85
SUHAREK	691	196	90,491.77	6,869.55	45,478.13
Total	10,460	3,486	1,296,558.68	191,673.93	944,890.97

3.2.5 RAPORTI I MEDIAVE

MUAJI: JANAR – DHJETOR 2017

Qëllimi i këtij raporti është nxjerrja në pah e aktiviteteve vjetore të Kompanisë, që kanë të bëjnë me përcjelljen e porosive në opinionin publik.

Zyra për marrëdhënie me publikun, është munduar që nga fillimi i vitit 2017, që përcjelljen e porosisë që del nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a., përmes mediave elektronike dhe të shkruara, ta bartë te opinionin publik, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të ndershme, njëkohësisht duke mbrojtur interesat e Kompanisë në përgjithësi dhe konsumatorit në veçanti.

Mediat lokale, i kanë kushtuar hapësirë të mjaftueshme KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. Kanë dhënë kontribut të madh në mënyrë indirekte dhe direkte në ngritjen e shkallës së arkëtimit, në vetëdijësimin e qytetarëve, se uji që shpenzohet duhet kursyer dhe duhet paguar, në informimin e qytetarëve se ujësjellësi i Prizrenit është duke punuar në atë drejtim që t'i përmirësojë shërbimet e veta ndaj çdo konsumatori, se kjo kompani me përkushtimin e saj më të madh, ka arritur që të përfitojë donacione të mëdha nga investitorët e huaj dhe Qeveria e Kosovës, vetëm e vetëm që konsumatorëve të saj t'u ofrojë shërbime sa më cilësore.

Edhe mediat e shkruara kanë dhënë kontribut të mjaftueshëm në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. dhe se hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

MUAJI: JANAR – DHJETOR 2017

Nr.	PËRSHKRIMI	MEDIAT	NUMRI TOTAL
1	<u>NJOFTIME</u> TV RADIO SHTYPI DITOR	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO HELIX RADIO OMEGA RADIO MALISHEVA MEDIA CENTER VALA RADIO SHARRI KOSOVA SOT EPOKA E RE ZËRI	35
2	<u>INTERVISTA</u> TV RADIO	RTK TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI KLAN KOSOVA RTK RADIO	10
3	<u>EMISIONE</u> TV RADIO	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO KOSOVA	10
4	<u>DEBAT PUBLIK – SHQYRTIMI I PROCESIT TARIFOR 2018-2020</u>	TV-OPINION TV- BESA TV-PRIZRENI	1
5	<u>KONKURSET</u> <u>ANULIM I KONKURSIT</u>	EPOKA E RE	15 3
6	<u>ARTIKUJT-SHTYPI DITOR</u>	KOHA DITORE KOSOVA SOT	19

		EPOKA E RE ZËRI	
7	<u>ARTIKUJT- SHTYPI ELEKTRONIK</u>	www.tv-opinion.com www.prizreni.tv www.rtvbesa.com www.ekonomiaonline.com www.mf.rks-gov.net www.newskosova.com www.kosovasot.info www.prizrenpres.com www.kosovapress.com www.koha.net www.gazetaexpress.com www.zëri.info www.rtk radio www.malishevapress.com www.epokaere.com www.balkanplus.net www.rtvbesa.facebook.com www.tv-prizreni.facebook.com www.tv-opinion.facebook.com www.therandapost.com	67
8	<u>PËRURIM I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT</u>	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI	1
9	<u>TAKIM ME “EC MA NDRYSHE”</u>	TV-OPINION TV- BESA TV-PRIZRENI	1
10	<u>NËNSHKRIMI I KONTRATËS RRETH 2 MILIONË EURO ME KOMPANINË “RAI COMERCE”</u>	TV- OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI	1

KONKLuzion

KRU-“Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren, gjatë vitit 2017, ka dërguar 35 njoftime në mediat elektronike dhe të shkruara, lidhur me të gjitha aktivitetet që i ka ndërmarrë kjo kompani.

Të gjitha njoftimet janë emetuar në televizione, e disa janë publikuar si shkrime në shtypin ditor, duke dhënë çdo herë një mesazh për opinionin publik.

Mediat janë për t`u lavdëruar në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” dhe hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

Mbulueshmëria mediale për KRU- "Hidroregjioni Jugor", për vitin 2017 ka qenë e kënaqshme dhe e mjaftueshme.

Mediat elektronike dhe të shkruara kanë kontribuar edhe në ngritjen e shkallës së arkëtimit në KRU- Hidroregjioni Jugor, duke plasuar informacione të shumta në publik.

3.3 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

3.3.1 Aktivitetet kryesore

Hyrje

Departamenti Administrativ është një nga Departamentet që ka lidhshmëri të drejtpërdrejt me Kryeshefin Ekzekutiv. Në kuadër të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë, bëjnë pjesë këto sektorë : sektori i administratës së përgjithshme dhe resurseve njerëzore, zyra ligjore, IT, zyrtari për sigurinë dhe shëndetin në punë, mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve.

Aktivitetet e përbashkëta të punës në Departamentin administratës:

Departamenti i administratës gjatë këtij viti është marr me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Në kuadër të raportit të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë janë përfshirë edhe raportet e sektorëve të departamentit të administratës si raporti i punës së zyrës ligjore, i resurseve njerëzore, zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë dhe raporti i punës së zyrës së teknologjisë informative për janar - dhjetor 2017.

- Gjatë këtij viti janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për staf dhe shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv I KRU "Hidroegjioni Jugor" sh.a Prizren . Për Vendimet dhe Rekomandimet e dala në takimet e BtD dhe Komisionit të Auditimit janë njoftuar të gjithë zyrtarët dhe udhëheqësit e Kompanisë pas përfundimit të procesverbalit të takimit përkatës.
- Pas aplikimit dhe plotësimit të dokumenteve të nevojshme nga zyrtarët e Kompanisë, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përkatësisht Agjensioni i regjistrimit të bizneseve në Kosovë janë ndërruar emrat e anëtarëve të Bordit në Certifikatën e regjistrimit të Kompanisë .
- Nga zyra ligjore gjatë vitit 2017 është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Dragashit, Malishevës dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbaaruesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.
- Është duke u punuar intensivisht Zyrtarja për burime njerëzore që në afat prej 30 ditëve të harmonizojë kontratat e punës të punonjësve sipas Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Kompanisë .
- Gjatë vitit 2017 janë përgatitur dhe vazhduar kontratat e punës që kanë qenë në kohë të caktuar për punëtorët e Kompanisë. Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës, raporti i vlerësimit i bërë nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punëtorit.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimit apo pëlqimit nga udhëheqësit e tyre.
- Në mbështetje të nenit 56 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212 , për punonjësit e Kompanisë është bërë kompensimi i punës jashtë orarit me ditë pushimi dhe përqindje të pagesës sipas ligjit në fjalë.

- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Nga udhëheqësit e departamenteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të shërbimeve përkatëse të Kompanisë është bërë vlerësimi vjetor i performancës së secilit punonjës për kryerjen e detyrave të punës në Kompani gjatë viti 2017.
- Gjatë vitit 2017 janë pensionuar 7 (shtatë) punëtor K.R.U. "Hidroregjioni jugor" Sh.A Prizren,
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Auditori i Jashtëm "Audit Conto" për vitin 2016.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Auditori i Brendshëm, lënda e auditimit ka qenë lidhur me menaxhimin e procesit të shqyrtimit të lëndëve gjyqësore në KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a për periudhën kohore TM3 dhe TM4-2016 si dhe TM1-2017.
- Në Departament të Administratës po ashtu kemi pasur auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 (Janar-qershor- 2017).
- Është bërë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje e duhur në azhurnimin e rregullt të ueb-faqes, siç parashihet me Ligj mbi NP, janë kryer të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetin përkatës sipas ligjit.
- Me autorizim të KE janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Është përgatitur Vendim me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv ku është formuar grupi punues i KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A që do të bëjnë hartimin e planit për menaxhimin e furnizimit me ujë në situata emergjente.
- Është përgatitur Vendim për mbikëqyrje të punimeve në njësinë e Suharekës gjatë punimeve në projektin "Zgjerimi i rrjetit në një lagje në Fshatin Dobërdelan .
- Është përgatitur Vendim me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv ku është formuar Komisioni që është përgjegjës për mbështetje dhe ofrimin e zgjidhjeve profesionale në konteste eventuale për konsulencën "P2M Berlin" gjatë realizimit të projektit "Ndërtimi i gypsjellësit të ri në segmentin e 40 Bunarët – rez." Shpati" respektivisht kyçja në rrjetin e qytetit të Prizrenit".
- Është përgatitur Vendim me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv ku është formuar grupi punues që do të bëjnë rivlerësimin e jetë gjatësisë së asetëve të KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a në Prizren për vitin 2017.
- Është përgatitur Vendim me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv janë riformuar Komisioni I përhershëm dhe i përkohshëm për shqyrtimin e Ankesave të konsumatorëve.
- Me Vendim është autorizuar Administratori i zyrës së TI (Teknologjisë Informative) në menaxhimin dhe operimin e plotë me sistemin informativ të Kompanisë duke përfshirë edhe qasjen në bazën e të dhënave të aplikacionit softuerik - Faturimi dhe NAVISION. Autorizimi bartë përgjegjësinë e plotë në ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave sikurse edhe funksionimin dhe operimin normal e efikas të sistemit informativ të Kompanisë.
- Sipas kërkesës ligjore të NJPMNP dhe në përmbushje të paragrafit 4 nenit 37 janë dërguar të dhënat për vitin 2016 gjegjësisht të hartuara dhe të miratuara gjatë vitit 2016, si më poshtë:
 - a. kompensimin, dhe kushtet e kompensimit, për secilin drejtor dhe zyrtar të NP-së;
 - b. Deklarata për politikën e kompensimit për drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e Kompanisë "Hidroregjioni Jugor" sh.a
 - c. të gjitha kontratat e prokurimit me vlerë të madhe, siç janë përkufizuar në Ligjin për Prokurim Publik;
 - d. të gjitha kontratat e prokurimit – pavarësisht nga vlera e tyre,
 - e. listën e dhjetë furnizuesve më të mëdhenj të saj për nga vlera e furnizimeve;
 - f. numrin e punonjësve të Kompanisë, të ndarë në bazë të divizioneve, dhe një pasqyrë të ndryshimeve mujore si dhe Rregulloret e Brendshme/NP, të miratuara dhe të nënshkuara duke përfshirë emrin e aktit dhe datën e aprovimit.

- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Sipas kërkesave nga udhëheqësit e njësive punuese Prizren, Suharekë dhe Malishevë dhe pas aprovimit nga Zyrtar Kryesor Financiar("ZKF") dhe Kryeshefi Ekzekutiv gjatë vitit kanë qenë të punësuar **15 (pesëmbëdhjete)** punëtor me kontratë për punë dhe detyra specifike.
- Sipas kërkesave të udhëheqësve të njësive punuese Prizren, Suharekë dhe Malishevë dhe pas aprovimit nga Zyrtar Kryesor Financiar("ZKF") dhe Kryeshefi Ekzekutiv në shtypin ditor janë shpallur **15 (njëzetepesë)** konkurse. Prej këtyre konkurseve tri janë anuluar, dhe dy konkurse janë rishpallur .
- Duke u bazuar në nevojën e rregullimit të procedurave për dëshmimin e përvojës së punës për të punësuarit në KRU" Hidroregjioni Jugor" sh.a, në mbledhjen e Menaxhmentit të Kompanisë është marr Vendim ku përcaktohen rregullat dhe procedurat për dëshmimin e përvojës së punës për të punësuarit në Kompani para dhe pas Qershorit të vitit 1999, me qëllim të pagesës shtesë mbi përvojën e punës si dhe realizimit të drejtave tjera që lidhen me pushimin vjetor.
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2017 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servisin e bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, porto-arkën, kërkuesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2017 gjërë më 15.01.2018 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të i dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpiloj raport mbi kryerjen e të njëjtës dhe t'ia dorëzoj Kryeshefit Ekzekutiv gjërë më 20.01.2018.
- Është përgatitur Vendim ku janë formuar komisionet për pranim teknik për punën e kryer në projektin" Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën" Marie Shllaku" Shirokë-Suharekë dhe për pranim teknik për punën e kryer në projektin" Rehabilitimi i burimit të ujit në fshatin Peqan-Suharekë. Komisionet do të kontrollojnë sasinë e punimeve të realizuara, kualitetin e punimeve dhe përgatisin raportin final për kualitetin dhe sasinë e realizuara të punimeve.
- Është përgatitur Vendim ku është formuar Komisioni I cili do të punojë në përpilimin e Projekt-rregullores për korrigjimin e borxheve kontestuese, lidhur me kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve.
- Është bërë Njoftim drejtuar Shukosit dhe Komisionit Parlamentar për Legjislacion lidhur me kundërshtimin e ndryshimit dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139(për procedurat e Përmbaruesve Privat), ku me Nenin 4, Paragrafi 1 i këtij Projektligji është paraparë që shpenzimet deri më tani kanë qenë barrë e debitorit, tani e tutje këto shpenzime sipas këtij Projektligji bien në barrë të Kreditorit gjegjësisht Kompanisë.
- Sipas Ligjit të Punës është përgatitur forma e kërkesës për punë jashtë orarit të cilën duhet ta arsyetoj udhëheqësi i shërbimit përkatës dhe forma e Aktvendimit I cili duhet të nënshkruhet nga punëdhënësi për punën më të gjatë se orari i plotë i punës së të punësuarit dhe paga shtesë në përqindje të pagës bazë, në bazë të nenit 56 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212.
- Në bazë të nenit 2. paragrafi 1. të Ligjit Nr. 2003/19 për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës dhe të nenit 5. paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, Punëtorit S,O i sistemuar në punët dhe detyrat e punës Përgjegjës për monitorim të fshatrave në njësinë e Prizrenit, i është bërë pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në vendin e punës.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është raportuar për kompensime dhe bonuse në total për vitin 2016 të Bordit të Drejtorëve dhe për pagat e zyrtarëve të lartë të Kompanisë gjithsej për vitin 2016.
- Është përgatitur urdhëresë për Shërbimin me Konsumatorë i Kompanisë, që ndaj konsumatorëve për të cilët është iniciuar dhe janë në procedurë përmbarimore, të njëjtit nuk do të përfitojnë falje të borxhit nga arsyeja që Ligji Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike

- nuk është më në fuqi. Me konsumatorët mundë të lidhet Kontrata – Marrëveshja për pagesën e borxhit ndaj Kompanisë me këste, por duke mos përfshirë faljen e borxhit.
- Është përgatitur vendim ku janë caktuar përfaqësuesit e Kompanisë për takime dhe konsultime me Kforin Gjerman lidhur me kontrollimin dhe pranimin teknik të rezervuarit të ujit në parcelën kadastrale 7334 në Prizren e cila aktualisht është duke u shfrytëzuar nga Kfori Gjerman.
 - Pas kërkesës për bashkëpunim në projektin e punësimit të të rinjve të bërë nga Kompania jonë, është nënshkruar Marrëveshje e bashkëpunimit për praktikë në punë të punëkërkuesve në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe KRU"Hydroregjioni Jugor". Marrëveshja do të fillojë se zbatuari me datë 20 Prill dhe do të zgjasë deri me 20 Tetor 2017. MPMS punëtorët e angazhuar do të paguaj me pagë mujore në shumën prej 250 euro në muaj dhe KRU"HRJ" do të bashkë financojë projektin duke siguruar mjetet e punës për punëtor si dhe shujtat ditore në vlerë prej 2.5 euro në ditë.
 - Duke u bazuar në nevojën e mirëmbajtjes së sistemit të kanalizimit është formuar me vendim ekip i veçantë për mirëmbajtjen dhe analizën e sistemit ekzistues të kanalizimit-Ujerave të zeza në qytetin e Prizrenit. Kjo ekip do të operojë përmes Departamentit Teknik dhe të njëjtit do të raportojë së paku në baza javore.
 - Në bazë të nenit 7. pika 2. Statutit të K.R.U"Hydroregjioni jugor"Sh.A me seli në Prizren, janë përpiluar dhe aprovuar dy rregullore të Kompanisë:
 - a) Udhëzimi për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë në KRU"Hydroregjioni Jugor"sh.a Prizren,
 - b) Rregullorja për iniciimin e procedurës përmbarimore të organi përmbarues,
 - c) Rregullore 01/2016 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve
 - d) Rregullorja Nr 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit
 - e) Rregullore Nr. 03 /2017 për Procedurat e Ndërprerjes së Shërbimeve të Ujit
 - f) Rregullore Nr. 04/2017 për Procedurat e Faturimit për Shërbimet e Ujit
 - g) Rregullore Nr. 05/2017 për Matjen e Konsumit të Ujit
 - h) Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hydroregjioni Jugor"Sh. A.- Prizren.
 - Është përgatitur Libri lidhës për Qeverisjen Korporatave për vitin 2016 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbarjtja e saj përfshinë : Certifikatën e regjistrimit të Biznesit,Vendimin mbi emërimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për vitin 2016, Vendimet e Bordit për 2016, Procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Deklarata e politikës së kompensimit,Vendimet mbi themelimin e komiteteve tjera të Bordit, Procesverbalet e komiteteve, Plan-Biznesi 2016-2018 dhe raporti vjetor 2016.
 - Përgatitja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
 - Përgatitja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
 - Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve,autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
 - Kanë bërë punë praktike profesionale student të Universitetit të Prishtinës në fushën e monitorimit të cilësisë së ujit të pijes (laborator të Kompanisë). Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikëqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
 - I është ndërprerë marrëdhënia e punës punëtorit fizik të njësisë punëse të Prizrenit I.K, ngase nuk është lajmëruar në vendin e tij të punës dhe nuk ka bërë asnjë njoftim me shkrim për mosardhjen e tij në punë. Në njoftim të udhëheqësit të tij thuhet se Punëmarrësi Ilir Krasniqi

gojarisht i ka deklaruar një punëtori të Kompanisë se nuk do të vazhdojë punën dhe do ta ndërpres kontratën e punës. Duke mos i arsyetuar ditët e mungesës nga puna punëmarrësi sipas Rregullores mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren, neni 5 paragrafi 22 sjelljen e tillë të punëmarrësit e parasheh si shkelje të rëndë të detyrave të punës. Andaj bazuar në Ligjin Nr. 03/L-2012, të datës 01.11.2010 të Punës, dhe Rregullores mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren është vendosur që punonjësit në fjalë të I ndërpritet Kontrata e punës nga data 06.02.2017.

- Punëtori I njësisë punuese të Suharekës A.O- punëtor fizik ka ndërprerë marrëdhënien e punës me vet dëshirë nga data 01.02.2017.
- Është bërë ndërprerje e kontratës së punës punëtorit N.B – Kontrollor – shkyçje, nga data 17.05.2017 për shkak te mos lajmërimit dhe mungesës në punë më tepër se 5 ditë pune pandërprerë. Duke mos i arsyetuar ditët e mungesës nga puna punëmarrësi sipas Rregullores mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren, neni 5 paragrafi 22 sjelljen e tillë të punëmarrësit e parasheh si shkelje të rëndë të detyrave të punës.
- I është shqiptuar Vërejtje me gojë të punësuarit Xh. K i sistemuar në punë dhe detyra të punës Kryesues i Zyrës së Prokurimit Publik në K.R.U."Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren, për shkak të shkeljes së lehtë të detyrave të punës.
- Pas shqyrtimit të lëndëve nga komisioni disiplinor dhe konstatimet e dala për punonjësit inkasantët R. Hajdari dhe I. Bityqi dhe ujëinstaluesit në njësinë ë Suharekës V. Jashari se kanë bërë shkelje të detyrave të punës I janë shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me shkrim.
- Pas inicimit të procedurës disiplinore ndaj punonjësit Inkasant A. S, për shkak të shkeljeve te lehta të detyrave të punës i shqiptohet masa disiplinore Vërejtje me shkrim.
- Është kërkuar nga MPMS që të vazhdohet kohëzgjatja e punës praktike të punëkërkuesve aktual të cilët kanë filluar angazhimin e tyre ne KRU' Hidroregjioni Jugor" që nga 20.04.2017 deri me 20.10.2017, dhe se vazhdimi të behët edhe për gjashtë muaj të tjerë.
- Pjesëmarrja në Konferencën dhe Ekspozitën e 5-të të Përbashkët Ballkanike me temë "Sfida e Ujit të Ndotur", organizuar më 1 - 3 nëntor në Prishtinë. Konferenca kjo që ofroi mundësi për ndarjen e eksperiencave dhe njohurive, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, në përpjekje për të ndihmuar zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në rajonin e Ballkanit.
- Takim pune me konsulencën DORSCH GROUP lidhur me organizimin e Kompanisë dhe Ligjet në bazë të cilave funksionojnë NP.
- Pjesëmarrja e punëtoreve-femra të Kompanisë në organizimin e CDI për nder të 8 Marsit me temë: Gratë dhe uji, puna me ujë është çështje gjinore. Integrimi gjinor-përfshirja e femrave e domosdoshme për vlerësimin e çdo veprimi të planifikuar në çështjet e ujit.
- Instituti GAP me qëllim të hulumtimit lidhur me pjesëmarrjen gjinore në ndërmarrjet publike në Kosovë ka kërkuar të dhëna për përbërjen gjinore në Kompani, Bord dhe sa është numri i punëtoreve në Kompani me pozitat e punës dhe ndarjen në M dhe F sipas pozitave, informatat apo përgjigjet e kërkuara janë plotësuar dhe dërguar me kohë në GAP.
- Vizitë (takim) në KUR Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren nga Komisioni i Faljes së borxheve me ç'rast është diskutuar lidhur me procesin, aktivitetet dhe veprimet të cilat i kemi ndërmarr në vazhdimësi në mënyrë që qytetarët të përfitojnë nga falja e borxheve, rastet sociale si dhe raporti I shërbimit me konsumator lidhur me borxhet nga vitit 2000-2014,sa janë falur sipas Ligjit ,sa janë paguar dhe numri i konsumatoreve qe kane lidhur marrëveshje për pagese te borxhit.

3.3.2 PERSONELI – JANAR- DHJETOR 2017

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	322	5			
Shkurt	321		3		
Mars	326	5		2	
Prill	325				
Maj	327	2	1	1	
Qersho	326				
Korrik	326			2	
Gusht	326				
Shtator	327				
Tetor	327			1	
Nentor	326			1	
Dhjetor	327				1

3.3.3 KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2016

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
DHJETOR	KUALIFIKIMI							
	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejt ë
Nr. i punëtorëve	32	36	1	209	1	47	1	327
Kualifikimi në %	9,79	10,01	0,31	63,91	0,31	14,37	0,31	100

3.3.4 NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR- 2017

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	279	35	5	8	327
Numri i Punëtorëve në %	85,3	10,7	1,5	2,4	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	42	12,84	
MESHKUJ:	285	87,16	
TOTAL	327	100,00	

Raport i numrit te punetoreve Janar - Dhjetor, 2016

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	Prakt.	Total			
1	Janar	328	235	6		241	37	15	35
2	Shkurt	327	235	6		241	36	15	35
3	Mars	332	238	6		244	36	16	36
4	Prill	331	239	6		245	36	15	35
5	Maj	333	240	6		246	36	16	35
6	Qershor	332	238	6		244	36	16	36
7	Korrik	332	240	6		246	36	15	35
8	Gusht	332	239	6		245	36	16	35
9	Shtator	333	240	6		246	37	15	35
10	Tetor	333	240	6		246	37	15	35
11	Nentor	332	239	6		245	38	15	34
12	Dhjetor	333	237	6	1	244	38	17	34

Rritja e planifikuar e numrit të personelit është bërë duke u bazuar në planifikimet dhe kërkesat me arsyeshmeri të Menaxherëve të Departamenteve dhe udhëheqësve të njësive operative të Prizrenit ,Suharekës,Malishevës dhe Dragashit.

Arsyeshmëria e rritjes së numrit të punëtorëve gjatë vitit 2017 është bërë me qëllim që të kemi menaxhim dhe një mbikëqyrje e punimeve në nivel profesional ne zona te reja te shërbimit. Numri i punëtorëve është planifikuar duke u marrë parasysh: formimi ekipeve të veçanta për mirëmbajtjen dhe analizën e sistemit ekzistues të kanalizimit-Ujërave të zeza në qytetin e Prizrenit, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale sipas projektit të zyrës Zvicerane, rritja e numrit të konsumatorëve si dhe duke u bazuar në rritjen e aktiviteteve dhe efikasitetin të punës në Kompani.

Gjatë planifikimit të vendeve të punës dhe themelimit të marrëdhënies së punës është respektuar Ligji i Punës., Ligji i Ndërmarrjeve Publike dhe Kodi i Etikës dhe se Kompania nuk bënë asnjë dallim apo diskriminim në organizimin apo caktimin e obligimeve të punës në të gjitha shërbimet

3.3.5 RAPORTI VJETOR NGA ZYRA LIGJORE E KOMPANISË

	Seanca për gatit ore	Seanca kryesor e	Seanca të shtyra	Shkresa të ardhura nga gjykatat
Janar	/	2	4	11
Shkurt	2	6	4	19
Mars	2	9	/	27
Prill	4	4	3	29
Maj	4	3	/	24
Qershor	2	3	3	27
Korrik	2	1	5	13
Gusht	4	5	2	9
Shtator	1	2	1	17
Tetor	5	2	/	27
Nëntor	1	1	/	21
Dhjetor	2	1	3	24
Totali	29	39	24	248

- Nga Gjykatat për periudhën kohore Janar - Shtator 2017, në total kanë ardhur **247 (dyqindtë e katërdhjetë e shtatë)** lëndë.
- Për **48 (katërdhjetë tetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë **Vendime** në favor të Kompanisë sonë.
- Për **26 (njëzet e gjashtë)** lëndë Gjykata ka marrë Vendim kundër Kompanisë sonë.
- **51 (pesëdhjetë e një)** Aktvendime sipas të cilave aprovohen pjesërisht Ankesat e Debitorëve lidhur me borxhin.
- **13 (trembëdhjetë)** Konkluzione sipas të cilit nga ne kërkohen Njoftime mbi adresat e konsumatorëve, a përfiton debitori sipas Ligjit mbi faljen e borxheve publike, të bëjmë propozime për caktimin e përfaqësuesve të përkohshëm, dhe Konkluzione tjera.
- **1 (një)** Marrëveshje gjyqësore.
- **1 (një)** Vërejtje për pagesë të taksës Gjyqësore.
- **1 (një)** Parashtrësë e debitorit me të cilën i njëjti e bënë precizimin e Prapësimit.
- **2 (dy)** Padi kundër kompanisë.
- **2 (dy)** Përgjigje në Padi.
- **9 (nëntë)** Ankesa të konsumatorëve lidhur me borxhet ndaj kompanisë.

RAPORTI VJETOR 2017 ME PËRMBARUESIT PRIVAT

	Njësia Punuese Prizren					Njësia Punuese Malishevë					Njësia Punuese Suharekë					Njësia Punuese Dragash				
	Propozime për Përmbarime	Marrëveshje	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Të përfunduara	Propozime për përmbarime	Marrëveshje	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Të përfunduara	Propozime për përmbarime	Marrëveshje	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Të përfunduara	Propozime për përmbarime	Marrëveshje	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Të përfunduara
Jan	42	1	3	3	1	19	1	1	1	/	31	17	6	6	3	/	1	1	1	/
Shku	40	4	3	3	2	20	6	4	4	1	21	7	2	2	/	22	/	/	/	1
Mars	20	16	6	6	2	28	5	4	4	2	25	8	/	/	1	23	2	3	3	/
Prill	39	5	1	1	3	/	6	/	/	5	21	2	4	4	1	/	/	2	2	1
Maj	19	8	2	2	1	21	5	/	/	2	18	5	8	8	4	19	1	/	/	/
Qersh	00	3	1	1	4	/	1	/	/	/	23	3	3	3	/	/	/	/	/	/
Korrik	26	3	3	3	4	/	7	/	/	2	13	/	2	2	/	/	6	/	/	/
Gusht	40	14	4	4	6	10	5	/	/	7	25	9	3	3	/	/	4	/	/	/
Shtat	38	12	6	6	7	11	1	/	/	4	23	4	4	4	3	/	4	1	1	/
Tetor	45	6	4	4	3	16	4	/	/	3	10	4	2	2	3	10	1	/	/	1
Nënt	13	/	4	4	1	/	8	/	/	1	11	7	5	5	4	/	/	1	1	/
Dhjet	14	5	/	/	4	/	1	/	/	1	13	17	1	1	4	22	3	/	/	4
Totali	336	77	37	37	38	125	85	9	9	28	234	83	40	40	23	96	22	8	8	7

Bashkëpunimi me Përmbaruesit Privat ka qenë në nivel, mirëpo sipas Përmbaruesve Privat lëndët do të kishin efikasitetit më të lartë, poqëse ato do të ishin të kompletuara konform dispozitave të LPK-së dhe konform dispozitave të LPP-së.

LËNDËT TË CILAT GJINDEN NË PROCEDURË DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	Emri, mbiemri dhe Adresa	C. nr	Kontesti	Vlera	Vërejtje
01	Remzi Hoxha nga Zhuri, KK Prizren	C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013	Padi -Kontest pune	Dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit
02	Xhezair Bajrami, KK. Dragash,	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për Dëmshpërblim	Dëmshpërblim në vlerë prej 25.753.52 Euro	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit
03	Fazli Kastrati nga Njësia Punuese e Malishevës	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi –Kontest pune	Dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës

1. C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013, **Padi për kthim në vendin e punës**, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
2. C. nr. 116/03, datë 08.05.2013, **Padi për dëmshpërblim**, dëmshpërblimi i kërkuar është në vlerë prej **25.753.52 Euro**, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
3. C. nr. 286/14 , datë 29.09.2014, **Padi –Kontest nga marrëdhënia e punës**, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Aktivitetet e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë për Vitin - 2017

- Për periudhën e vitit 2017 janë bërë kontrollimet e objekteve në njësinë punuese në Prizren në këto vende 40 Burimet –I, 40 Burimet –II, te Mulliri i Vjetër, Kuagulatorët, Filtrat, objekti i vjetër i shërbimit operativ, kontrollimi i gjendjes në objektin e vjetër të “Hidroregjionit” si dhe kontrollimi i objektit ku gjendet administrata e K.R.U.”Hidroregjionit” në Prizren. Gjatë kontrollimeve në gjitha vendet janë kontrolluar aparatet kundër zjarrit, sistemimi i tyre dhe afatet e servisimit, njëherit është pecjellur gjendja e pastërties së objekteve dhe hapësirës për rreth objekteve, janë kontrolluar gjendja e hidrantëve, sistemimi i bombolave të klorit etj.
- Pjesëmarrja në Punëtori pune me karakter trajnues për planifikimin e menaxhimit të aseteve, takimi është mbajtur në ARRU – Prishtinë.
- Gjatë vitit është bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operative gjatë realizimit të punimeve gjatë eliminimit të defekteve në njësinë e Prizrenit, kontrollimi i punëtorëve lidhet me sigurinë dhe respektimin e masave të mbrojtjes në punë.
- Gjatë vitit 2017 janë servisuar të gjitha aparatet kundër zjarrit dy here për njësinë Suharekë, njësinë Malishevë dhe njësinë Dragash. Servisimi i aparateve kundër zjarrit, është realizuar nga firma SAP-Internacional sh.p.k përmes procedurave të tenderimit, dhe sipas njësive punuese janë të servisuar :
 - a) -Njësia Prizren: janë servisuar 41 aparate kundër zjarrit prej tyre 4 aparatet janë për automatet,
 - b) -Njësia Malishevë: janë servisuar 15 aparate kundër zjarrit
 - c) -Njësia Suharekë: janë servisuar 9 aparate kundër zjarrit
 - d) -Njësia Dragash: janë servisuar 5 aparate kundër zjarrit
 Numri i aparateve kundër zjarrit në KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a në Prizren ka gjithsej 70 aparate dhe janë sistemuar sipas raportit të përshkruar.
- Gjatë tërë vitit janë realizuar kontrollimet e objekteve të Kompanisë të “Hidroregjionit Jugor” lidhur me gjendjen dhe mirëmbajtjen e tyre, njëherit është duke u bërë edhe vlerësimi i shkallës të rrezikshmërisë nga firmën “HSK. L.L”- Prishtinë për të gjitha vendet e punës, në të gjitha njësitë si dhe për të gjitha stacionet e pompimit dhe vendet e rojtarëve.

Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për 2017

Përshkrimi hyrës;

Aktivitetet e punës së përditshme janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezantohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka pasur peshe dhe ndikim të veçantë.

Raporti

Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

- Ndërrhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 111 herë.
- Ndërrhyrje në Komune – Malisheve: 93 here
- Ndërrhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 204 herë.
- Ndërrhyrje në Komune – Suhareke: 77 here.
- Ndërrhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 100 herë.
- Ndërrhyrje në njësitë Shatërvan: 204 herë.
- Ndërrhyrje në njësitë Depo: 65 herë.
- Ndërrhyrje në njësinë Filtrat: 274 herë.
- Ndërrhyrje në Komunë - Prizren: 180 herë.
- Ndërrhyrje në Ueb Faqe 31 herë; Njoftime për konsumatore, gjithsejtë 20, ngarkim i dokumenteve, gjithsejtë 11.
- Ndërrhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 2393 herë.
- Përkujdesje për qasjen e Kompanisë në rrjetin e internetit.
- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverëve të Njësi, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- Planifikim i infrastrukturës së mëturjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të Kompanisë.
- Riparim harvderik dhe softverik të pajisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- Mbikëqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe serviseve të pajisjeve kompjuterike e pajisjeve të ngjashme teknike.

- Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.
- Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.
- Riparim i fotokopjes se faturave „Xerox 4110“ bashke me MIRI Xerox Service.
- Ndërrim i tonerëve te fotokopjes se faturave „Xerox 4110“ dhe 5645.
- Përkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve. Serveri Databaze, GIS, DNS.
- Përkujdesje për garancionet e pajisjeve dhe dertimin e pajisjeve te amortizuara për asgjësim ne Depo.
- Rregullim i telefonit dhe internetit tek zyra e rojeve ne Baze.
- Përkujdesje për shënimin dhe organizimin e furnizimit te pajisjeve nga furnitori
